



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarija za Dobro Upravljanje / Office on Good Governance

RAPORT I VLERËSIMIT

ZBATIMI I STRATEGJISË QEVERITARE
PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE
2019-2023

Prishtinë, shkurt 2024



Ky raport i realizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë me përkrahje të Platformës Civikos, është bërë i mundur nga mbështetja bujare e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Përkrahja e Platformës Civikos në realizimin e raportit u bë e mundur përmes Programit për Angazhim Qytetar, i cili zbatohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në Kosovë. Platforma Civikos është partnere e KCSF në realizimin e këtij aktiviteti.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarija za Dobro Upravljanje / Office on Good Governance

RAPORT I VLERËSIMIT

ZBATIMI I STRATEGJISË QEVERTARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2019-2023

Prishtinë, shkurt 2024

PËRMBAJTJA

6	SHKURTESAT
7	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
10	1. HYRJE
11	1.1 Metodologjia e vlerësimit
13	2. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË QEVERTARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2019-2023
13	2.1 OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: RRITJA E PJESËMARRJES SË SHOQËRISË CIVILE NË POLITIKË-BËRJE
24	2.2 OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: PËRMIRËSIMI I KORNIZËS INSTITUCIONALE DHE LIGJORE PËR FINANCIM NË ZHVILLIMINE QËNDRUESHËM TË PROGRAMEVE DHE PROJEKTEVE TË OSHC-VE ME INTERES PUBLIK
35	2.3. OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: ZHVILLIMI I PRAKTIKAVE DHE PROCEDURAVE TRANSPARENTE PËR KONTRAKTIMIN E OSHC-VE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE
39	2.4. OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: RRITJA DHE PROMOVIMI I VULLNETARIZMIT NË PROGRAMET ME INTERES PUBLIK
43	3. MEKANIZMAT INSTITUCIONAL PËR MBIKQYRJEN E ZBATIMIT TË STRATEGJISË
45	4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME
47	LISTA E REFERENCAVE
49	SHTOJCAT
50	SHTOJCA I. Zbatimi i aktiviteteve sipas objektivave të Strategjis
58	SHTOJCA 2: Lista e pjesëmarrësve në Puntori/fokus grupin e Organizuar më 24.10.2023 për Vlerësimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile
59	SHTOJCA 3: Lista e personave të intervistuar gjatë procesit të Vlerësimit të Zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile

SHKURTESAT

BE	Bashkimi Evropian
CEA	Programi për Angazhim Qytetar
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
KCSF	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
KLGI	Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale
MKRS	Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport
OECD/SIGMA	Organisation for Economic Cooperation and Development/Support for Improvement in Governance and, Management and Administration
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
TACSO	Technical Assistance to Civil Society Organizations
UNICEF	United Nations Children’s Fund
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qeveria e Republikës së Kosovës më 12 shkurt 2019 ka miratuar Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 (në vijim Strategjia). Strategjia e shoqëruar me një plan të detajuar të zbatimit të saj përbën fazën e dytë të planifikimit strategjik e cila vendosë objektiva, synime dhe aktivitete për bashkëpunim mes Qeverisë dhe Shoqërisë Civile gjatë periudhës afatmesme 2019-2023. Me miratimin e Strategjisë, Qeveria tregon përkushtimin e saj për të investuar burime plotësuese financiare dhe njerëzore me qëllim të krijimit të mekanizmave funksional për një bashkëpunim të strukturuar në mes të Qeverisë dhe Organizatave të Shoqërisë Civile. Kjo do të ndihmojë në formësimin dhe zbatimin e politikave publike si dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile. Për të arritur këtë synim janë vendosur katër objektiva strategjike për periudhën e zbatimit 2019-2023: 1. Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje, 2. Rritja e llogaridhënies dhe transparencës në financimin publik për OSHC-të, 3. Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike, dhe 4. Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programet me interes publik.

Konsiderohet se për arritjen e objektivit *“Pjesëmarrja e shoqërisë civile në politikë-bërje”*, progres më i theksuar është shënuar në rritjen e përfshirjes së OSHC-ve në grupe punuese gjatë hartimit të dokumenteve publike. Po ashtu, ka pasur arritje të synimeve në aktivitetet e organizuara për ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve apo mentorimeve për nëpunësit, është bërë avancimi i platformës me qasjen nga personat me aftësi të kufizuara, si dhe është bërë zgjerimi i komponentës së sistemit të konsultimit për nivelin lokal të qeverisjes. Në përgjithësi, publikimi i dokumenteve për konsultim publik konsiderohet në nivel të duhur dhe me një shkallë prej 77% të plotësimi formal të standardeve minimale.

Megjithatë, ndër ngecjet në zbatimin e Strategjisë në objektivin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në procesin e politikëbërjes evidentohet se kishte një fokus të theksuar në përmbushjen e kriterëve formale të konsultimeve, ndërsa më pak i është kushtuar kujdes cilësisë së procesit të konsultimit. Shkalla e ofrimit të kontributeve përmes platformës elektronike të konsultimeve publike është shumë e ulët në krahasim me ato që ofrohen përmes metodave tjera të konsultimeve. Nuk është bërë shumë në kërkesat që platforma të bëhet më e lehtë për përdorim për të gjitha kategoritë e qytetarëve. Pastaj një nga sfidat e procesit të konsultimeve është përfshirja e vonshme e palëve të interesuara në procesin e konsultimit, por edhe në adresimin e shqetësimeve të palëve se kontributet nuk merren parasysh, apo nuk ofrohet informacion i mjaftueshëm për kontributet që japin për dokumentet e konsultuara.

Në kuadër të objektivit *“Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OSHC-ve me interes publik”* është shënuar progres në arritjen e synimeve të ndërlidhura me aplikimin e kriterëve, standardeve dhe procedurave për financimin publik të OSHC-ve. Institucionet publike në nivel qendror dhe lokal ofrojnë mbështetjen financiare publike për OSHC-të, përmes thirrjeve publike. Nga analiza e një numri të thirrjeve publike, nga diskutimi me përfaqësues të OJQ-ve, dhe analiza e raporteve të auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit mund të konstatohet se në masë të madhe janë në përputhje me kriteret e Rregullores MF. Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OSHC-ve. Gjatë periudhës që ka mbuluar Strategjia, janë ofruar trajnime për zyrtarët publik dhe janë vendosur mekanizma koordinues për të përmbushur detyrimet e raportimit për mbështetjen financiare publike për OSHC-të, duke përfshirë edhe përmirësimin e dukshëm të platformës për raportimin e financimit publik për OSHC-të. Kjo ka ndikuar në rritje të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike sa i përket financimit publik të OSHC-

ve. Përveç kësaj, janë vendosur rregulla për ndarjen e pronës publike komunale për OSHC-të dhe janë ofruar trajnime për të zbatuar këto kritere. Për të mbajtur këtë sistem funksional dhe për të avancuar më tej, nevojiten ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve institucionale.

Sa u përket objektivave specifike që kanë të bëjnë me fushat që ndërlidhen me filantropinë individuale dhe të korporatave, duke përfshirë rishikimin e kornizës ligjore dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale në këtë fushë, nuk është shënuar progres. Progres nuk është shënuar as sa i përket krijimit të bazës ligjore për bashkëfinancim të projekteve të OSHC-ve dhe treguesve tjerë të rezultateve siç parashihej me Strategji. Objektivi strategjik si i tillë dhe të gjitha objektivat specifike, vazhdojnë të mbesin relevante për të siguruar një sistem për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OSHC-ve.

Në kuadër të objektivit strategjik ***“Zhvillimi i praktikave dhe procedurave transparente për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike”*** nuk ka pasur rezultate në kuptimin e arritjes së treguesve të përcaktuar me Strategji. Megjithatë, është filluar të punohet në krijimin e bazës ligjore sa i përket kontraktimit të shërbimeve, ku Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka themeluar Grupin Punues për Hartimin e Rregullores për Kontraktimin e Shërbimeve me OJQ-të. Në bashkëpunim me OSHC-të, është kryer një analizë e kornizës ligjore që mbulon fushën e kontraktimit të shërbimeve, i titulluar ***“Dokument i politikave lidhur me kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të”***¹, e cila ka nxjerrë përfundime se Ligji për Prokurim Publik mundëson nxjerrjen e akteve nënligjore me të cilat do të mundësohej kontraktimi i shërbimeve publike me OSHC-të. Gjithashtu, edhe pse është në fazat e hershme, pritet të fillojë puna në hartimin e Rregullores për kontraktim të shërbimeve publike me OSHC-të, që buron nga Ligji i Prokurimit Publik. Në mungesë të një rregullative të tillë, edhe pse natyra e shërbimeve që ofrojnë OSHC-të mbulon fusha që do duhej të kryheshin nga institucionet, sikurse është rasti i shërbimeve sociale dhe familjare, institucionet publike janë të detyruara të ofrojnë financim publik në formë subvencioni/granti për OSHC-të përmes rregullores MF. Nr. 04/2017.

Nga analizat e kryera nga OSHC-të, del se një numër i konsiderueshëm i OSHC-ve ofrojnë shërbime, në veçanti shërbime sociale dhe familjare. Megjithatë, edhe pse institucionet e kanë të domosdoshme të kontraktojnë shërbime, ato nuk kanë një bazë të qartë ligjore për të bërë një gjë të tillë vetëm me OSHC-të. Krahas krijimit të bazës ligjore për kontraktim të shërbimeve, definimi i aktiviteteve ekonomike të OSHC-ve në raport me legjislacionin tatimor, dhe ngritja e kapaciteteve institucionale për kontraktim të shërbimeve, janë të domosdoshme të trajtohen me prioritet edhe në planifikimin e mëtejshëm strategjik.

Tek objektivi strategjik ***“Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programet me interes publik”*** ka pasur zbatim shumë të ulët të aktiviteteve të planifikuara me Strategji. Është hartuar draft koncept dokumenti për vullnetarizmin, platforma elektronike për vullnetarët, si dhe një studim për Ekosistemin e Vullnetarizmit në Kosovë, i cili është në fazën e finalizimit. Janë identifikuar raste të shumta të financimit të vullnetarizmit nga komunitat, si dhe aktivitete të shumta vullnetare, por të cilat janë jashtë kornizës së planifikimit strategjik.

Mosfinalizimi i projekt Koncept Dokumentit për zhvillimin e Vullnetarizmit në Kosovë ka shkaktuar pengesë në zbatimin e shumë aktiviteteve që lidhen me vullnetarizmin. Gjithashtu, ka paqartësi në lidhje me opsionet dhe politikat që vendosen me Koncept Dokumentin. Megjithatë, edhe pse ka shumë aktivitete vullnetare, mungon legjislacioni, kapacitetet dhe sistemi i Qeverisë për të mbështetur këto aktivitete. Për më tepër, platforma elektronike është e kufizuar vetëm tek rinia dhe ka nevojë për përmirësime dhe mbështetje për mirëmbajtjen e saj.

1 Platforma CIVIKOS, Dokument i politikave lidhur me kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të, 2022. I qasshëm në: <https://civikos.net/wp-content/uploads/2023/12/DOKUMENT-I-POLITIKAVE-LIDHUR-ME-KONTRAKTIMIN-E-SHERBI-MEVE-NGA-OSHC-te.pdf>

Progresi i përgjithshëm i arritjes së objektivave dhe zbatimit të aktiviteteve prezantohet përmes figurave 1 dhe 2 si më poshtë. Siç prezantohet në figurën 1, progresi i arritjes së objektivave është përmbledhur sipas matjes së treguesve të suksesit për secilin tregues, si në nivel të objektivave të përgjithshme, ashtu edhe objektivave specifike. Në këtë rast tregohet se nga gjithsej 33 tregues, 3 janë arritur plotësisht ashtu siç ishte synuar në vitin 2021, 2 të tjerë janë arritur në vitin 2023, 4 të tjerë janë arritur pjesërisht, ndërsa për 19 tregues nuk ka pasur zhvillime fare. Ndërsa arritja e synimeve për 4 tregues nuk kishte mundësi të vlerësohej për shkak se për arsye të ndryshme, informatat kanë munguar (p.sh. për të vlerësuar treguesit e shkallës së përkrahjes së qytetarëve për vullnetarizmin, do duhej të zhvilloheshin hulumtime përkatëse).




Figura 1: Shkalla e arritjes së objektivave sipas treguesve

Në nivel të aktiviteteve, nga gjithsej 48 aktivitete sa ka plani për periudhën 2019-2021, deri në muajin nëntor 2023 janë zbatuar plotësisht gjithsej 17 aktivitete, ose 35%; dy aktivitete ose 4% janë pjesërisht të zbatuara; gjashtë aktivitete ose 17% janë në proces të zbatimit, ndërsa 21 aktivitete ose 44%, mbeten të pazbatuara (shih figurën 2).




Figura 2: Statusi i zbatimit të aktiviteteve në të gjitha objektivat

1. HYRJE

Shkalla e bashkëpunimit mes institucioneve qeveritare dhe shoqërisë civile është një nga treguesit dhe parimet për një qeverisje të mirë, transparente, gjithpërfshirëse dhe llogaridhënëse. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën thekson se një shoqëri civile e fuqizuar është një komponent kyç i çdo sistemi demokratik dhe vazhdon të njihet si e tillë nga institucionet publike. Shoqëria civile mbetet një partner i rëndësishëm në kuadër të përgatitjes së Kosovës për anëtarësim në BE, pasi ajo kontribuon në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e reformave të lidhura me BE-në dhe merr pjesë në platformat e dialogut të politikave të Stabilizim Asociimit². Prandaj, zhvillimi i bashkëpunimit në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile në formësimin dhe zbatimin e politikave publike është thelbësore në zhvillimin gjithpërfshirës të qeverisjes së orientuar drejt qytetarit dhe respektimin e diversitetit në të gjitha aspektet e shoqërisë.

Udhëzuesi për Mbështetje të BE për Shoqërinë Civile në Rajonin e Zgjerimit 2021-2027³ ashtu si edhe parimet e miratuara nga Drejtoria e përgjithshme për Zgjerim e BE-së, theksojnë rëndësinë e vendosjes së objektivave të qarta, rezultateve dhe treguesve për monitorimin e përparimit të qeverive në këtë fushë. Këto elemente janë bërë një pjesë e rëndësishme për kriteret politike dhe pasqyrohen rregullisht në raportet vjetore për progresin e Kosovës. Zhvillimi i shoqërisë civile dhe demokratizimi përfshihen si elementet e para mbi të cilat palët janë pjesë e Parimeve e OECD/SIGMA për Administratën Publike” të cilat udhëheqin administratat e zgjerimit dhe fqinjësisë së Bashkimit Evropian në përpjekjet e tyre reformuese për të adresuar mangësitë në administratën e tyre publike dhe për të përmbushur kërkesat e BE-së për një nga “themelet” e procesit të anëtarësimit⁴.

Në kuadër të kontekstit të Kosovës, aktivitete të ndryshme të bashkëpunimit me shoqërinë civile janë zhvilluar në vazhdimësi nga ana e Qeverisë, si dhe ka ekzistuar një qasje aktive nga ana e Organizatave të Shoqërisë Civile në ofrimin e mbështetjes së tyre për proceset e vendimmarrjes. Megjithatë, bashkëpunimi i tillë ka kërkuar një qasje strategjike dhe të qëndrueshme. Për të arritur një qëllim të tillë, Qeveria e Republikës së Kosovës, së bashku me Organizatat e Shoqërisë Civile, kanë themeluar mekanizma institucional, procese dhe struktura të përbashkëta. Një nga këta mekanizma është planifikimi strategjik i zhvillimit të këtij bashkëpunimi. Në këtë rast, Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 është dokumenti kyç që definon kornizën planifikuese të bashkëpunimit në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shoqërisë Civile. Përmes kësaj strategjie, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte përcaktuar objektiva afatmesme dhe masa për përmirësimin e mjedisit përkrahës në zhvillimin e shoqërisë civile si dhe krijimin e parakushteve për një bashkëpunim më efektiv mes OShC-ve dhe sektorit publik.

Përmes Strategjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka shprehur vullnetin e saj politik dhe angazhimin për të ndërmarrë hapa të mëtejshëm drejt përmirësimit të ambientit të pjesëmarrjes së shoqërisë civile, në veçanti Organizatave të Shoqërisë Civile, në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes qeveritare. Qeveria ka miratuar politika dhe mekanizma për rregullimin dhe avancimin e sistemit të mbështetjes financiare të sektorit të shoqërisë civile nga ana e qeverisë, duke ofruar mundësi për Organizatat e Shoqërisë Civile për të dhënë kontributin e tyre në ofrimin

2 European Commission Report on Kosovo 2023 f. 10. Shih: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf

3 DG NEAR Guidelines for EU Support to Civil Society in the Enlargement Region 2021-2027 shih: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/EU-Guidelines-for-Support-to-Civil-Society-in-the-Enlargement-region-2021-2027.pdf>

4 OECD/SIGMA Principles of Public Administration. <https://www.sigmapweb.org/publications/principles-public-administration.htm>

e shërbimeve. Përveç kësaj është synuar rregullimi i sistemit të vullnetarizmit dhe mbështetja e punës së vullnetarëve në Kosovë.

Këshilli për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile i themeluar në vitin 2019 nga Qeveria, ka luajtur një rol të rëndësishëm në monitorimin e zbatimit të politikave dhe aktiviteteve të planifikuara me Strategji, si dhe në këshillimin e proceseve për koordinimin e proceseve të bashkëpunimit midis Qeverisë dhe shoqërisë civile. Në të njëjtën kohë, Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit ka luajtur një rol të rëndësishëm në procesin e raportimeve të rregullta mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të saj të Veprimit. Si rezultat, raportimi i zbatimit të Strategjisë dhe shqyrtimi i raporteve të monitorimit është bërë në baza të rregullta nga ana e Këshillit.

Përveç monitorimit, ashtu siç është paraparë me rregullat relevante për hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre, Strategjia ka paraparë një vlerësim final i cili si rregull bëhet pas finalizimit të zbatimit të saj. Si rrjedhojë ky vlerësim ka për qëllim që të ofrojë informacionin e duhur dhe analizën e arritjes së objektivave të Strategjisë dhe të vendosë bazën për fazën tjetër të planifikimit strategjik të bashkëpunimit mes Qeverisë dhe Shoqërisë Civile.

1.1 Metodologjia e vlerësimit

Qëllimi i vlerësimit të Strategjisë është të identifikohen sukseset, ngecjet, sfidat dhe mësimet e nxjerra gjatë zbatimit të saj gjatë periudhës 2019-2023. Procesi i vlerësimit ka për qëllim të mundësojë transparencë dhe llogaridhënie në zbatimin e aktiviteteve të parapara me Strategji si dhe të krijojë një bazë të informacionit i cili mund të përdoret për rishikimin dhe përmirësimin e ciklit të ardhshëm planifikues strategjik për bashkëpunim mes Qeverisë dhe shoqërisë civile në Kosovë.

Vlerësimi i zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile është i bazuar në metodën e Vlerësimit të përzier (kombinuar) në të cilin Zyra e Kryeministrit, si institucion përgjegjës për të bërë vlerësimin, ndihmohet nga ekspertë të jashtëm të pavarur në kryerjen e detyrave të vlerësimit, duke përfshirë grumbullimin dhe analizën e të dhënave dhe përgatitjen e vlerësimit. Vlerësimi është *ex-post* (përfundimtar) lidhur me zbatimin e gjithë Strategjisë. Prandaj, përmes vlerësimit të zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile synohet të arrihen këto objektiva: a) Të bëhet një analizë e përgjithshme e zbatimit të Strategjisë për periudhën 2019-2023, duke përfshirë treguesit e performancës; b) Të analizohet zbatimi i Strategjisë i bazuar në aktivitetet e përcaktuara në kuadër të objektivave të Strategjisë; c) Ofrimi i rekomandimeve për veprim të mëtutjeshëm, duke përfshirë edhe hartimin e strategjisë së ardhshme. Prandaj, metodologjia e përdorur në vlerësimin e Strategjisë ka përfshirë metodën mikse të mbledhjes së të dhënave (sasiore dhe cilësore), intervistat dhe një fokus grup me të gjithë akterët, përmes të cilit është synuar të bëhet një validim i të dhënave të dala nga vlerësimi.

Sipas metodologjisë për vlerësimin e dokumenteve strategjike, dimensionin e vlerësimit ishte *ex-post*. Vlerësimi ka synuar të nxjerrë rezultate për kriteret standarde të vlerësimit si: a) relevanca; b) efektiviteti, c) efikasiteti; d) ndikimi dhe e) qëndrueshmëria, siç parashihet me manualin për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit. Pyetjet të cilat kanë shërbyer për orientimin e vlerësimit në kuadër të kriteteve janë:

Efektiviteti

- Deri në çfarë mase janë zbatuar veprimet/masat e Planit të Veprimit?
- Cilat kanë qenë rezultatet e realizuara në raport me objektivat specifike?
- Deri në çfarë mase janë arritur objektivat?

Efikasiteti

- A janë ndarë burime të mjaftueshme për arritjen e objektivave strategjike?
- Çfarë burimesh plotësuese do të jenë të nevojshme për zbatim më efikas?

Relevanca

- Deri në çfarë mase Strategjia ka qenë relevante në funksion të nevojave aktuale në Kosovë?
- Deri në çfarë mase Strategjia ka qenë e rëndësishme në aspektin e përmbushjes së kërkesave për pranim në BE?

Ndikimi

- Çfarë ka ndodhur si rezultat i Strategjisë?
- Çfarë ndryshimi ka bërë Strategjia për grupet e ndryshme të përfituesve (dhe për publikun e gjerë në përgjithësi)?
- Si janë prekur grupet e ndryshme të synuara?

Qëndrueshmëria

- A do të vazhdojnë përfitimet pas zbatimit të Strategjisë?
- A mund të jenë ndikimet afatgjata?
- Çfarë mund të bëhet për të siguruar që ato të mbeten të qëndrueshme?

Fokusi primar i vlerësimit ishte në vlerësimin e Strategjisë mbi bazën e objektivave të saj strategjike, objektivave specifike dhe treguesve të performancës, por, duke përfshirë edhe të dhëna sa i përket përmbushjes së aktiviteteve të parapara. Orientimi kryesor, por jo vetëm, për vlerësimin nëse janë arritur objektivat, ishin synimet e vendosura për secilën objektivë strategjike dhe specifike, në kuadër të treguesve të tyre.

Në realizimin e vlerësimit, ekspertët janë bazuar kryesisht në këto burime të të dhënave: Raportet vjetore të zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqëri Civile të përgatitura nga Zyra për Qeverisje të Mirë; Raportet vjetore sa i përket Procesit të Konsultimeve Publike; Raportet vjetore mbi financimin Publik të OShC-ve; Raporte të Auditimit të Pasqyrave Financiare të Institucioneve Publike; Raporte të Auditimit të Performancës nga Zyra Kombëtare e Auditimit; Raportet e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për periudhën e zbatimit të Strategjisë në vlerësim; Analizat dhe raportet e përgatitura nga Organizatat e Shoqërisë Civile, për Strategjinë për Bashkëpunim me Shoqëri Civile si tërësi por edhe për aspekte specifike të zbatimit të saj; analiza, punime shkencore, anketa dhe materiale tjera relevante për të bërë të mundur vlerësimin e Strategjisë si tërësi – lista e plotë e burimeve mund të konsultohet në listën e referencave, f. 46. Përveç burimeve të mësipërme, ekspertët kanë zhvilluar intervista individuale me përfaqësues të Qeverisë dhe të Shoqërisë Civile dhe akterëve tjerë relevantë që mbulojnë fushën e zbatimit të Strategjisë (shtojca nr. 2), dhe aktiviteteve specifike në kuadër të planit të saj të veprimit. Gjatë procesit të Vlerësimit është organizuar edhe një fokus grup (shtojca nr. 1). Qëllimi i fokus grupit, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për koordinim dhe zbatim të Strategjisë, Organizatave të Shoqërisë Civile dhe ekspertë, ishte diskutimi i gjetjeve nga procesi paraprak i vlerësimit dhe validimi i të dhënave të mbledhura, mbledhja e informatave shtesë.

Vlerësimi i zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 është kryer nga ekspertët Qerkin Berisha dhe Ruzhdi Halili, në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar, i cili zbatohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në Kosovë. Platforma CIVIKOS është partnere e KCSF në realizimin e këtij aktiviteti.

2. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË QEVERTARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2019-2023

2.1 OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: RRRITJA E PJESËMARRJES SË SHOQËRISË CIVILE NË POLITIKË-BËRJE

Në nivel të objektivit strategjik “Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje”, nga dy tregues sa kishte objektivi, synimi është arritur plotësisht për njërin tregues në vitin 2021 ndërsa synimi për treguesin tjetër është arritur në vitin 2023. Në nivel të objektivave specifike, nga gjashtë tregues, katër janë arritur pjesërisht, ndërsa për dy tregues nuk ka informata për të bërë vlerësimin (shih tabelën nr. 1).

Vlerësimi i Efektivitetit

Efektiviteti i zbatimit të Strategjisë është bërë duke ju përgjigjur pyetjeve: Deri në çfarë mase janë arritur objektivat? Cilat kanë qenë rezultatet e realizuara në raport me objektivat specifike? Deri në çfarë mase janë zbatuar veprimet/masat e Planit të Veprimit?

Objektivi i parë strategjik “Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje” mbështetet nga dy tregues të performancës. Treguesi i parë “*numri i OSHC-ve të përfshira në ekipet e punës për hartimin e politikave të reja dhe fazat e hershme të zhvillimit të legjislacionit*” synon të vlerësojë shkallën e pjesëmarrjes së OSHC-ve në fazat e hershme të procesit të vendimmarrjes, respektivisht përfshirja në ekipet e punës për hartimin e politikave të reja nga ana e institucioneve. Ndërsa në momentin e hartimit të Strategjisë kishte 50 OSHC të cilat kishin qenë të përfshira në grupet punuese, synimi në vitin 2021 ishte që kjo pjesëmarrje të rritej në 150 OSHC. Sipas të dhënave zyrtare të pranuar nga Zyra e Kryeministrit, numri i përgjithshëm i pjesëmarrjes në grupet punuese në të gjitha dokumentet e hartuara nga institucionet gjatë viteve 2019-2023 ishte 1109 (shih figurën numër 3, të dhënat në figurë janë të ndara për vite dhe lloje të dokumenteve). Vetëm gjatë vitit 2021 numri i OSHC-ve të përfshira në grupet punuese ishte 225 ndërsa synimi për këtë vit sipas planit të Strategjisë ishte 150 OSHC (shih detajet në figurën nr. 3). Të dhënat tregojnë rritje përmbajtësore të përfshirjes së OSHC-ve në fazat e hershme të procesit të konsultimeve nga ana e institucioneve udhëheqëse për hartimin e dokumenteve publike. Ndërsa në anën tjetër, mjedisi për veprim të shoqërisë për pjesëmarrjen në proces të konsultimeve publike vlerësohet pozitive nga ana e Komisionit Evropian. Sipas raportimit të Komisionit Evropian për vitin 2023 “*në përgjithësi shoqëria civile vepron në një mjedis të favorshëm. Shoqëria civile vazhdon të marrë pjesë aktivisht në konsultimet publike dhe kontribuon në proceset e hartimit dhe monitorimit të politikave*”.⁵

⁵ European Commission Report on Kosovo 2023 f. 10. Shih: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SËD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf




Figura 3: Numri i OSHC-ve të përfshira në ekipet e punës për hartimin e politikave të reja dhe fazat e hershme të zhvillimit të legjislacionit. Burimi: Të dhënat e ofruara nga Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit.

Megjithatë, specifiku i përfshirja në fazat e hershme të konsultimit paraqitet si një nga mangësitë e procesit të konsultimit. Konstatimi i Komisionit Evropian në raportin 2022 për Kosovën se konsultimet publike për projekt-legjislacion të ndryshëm organizohen shumë vonë në proces⁶ është konfirmuar nga shumë të intervistuar që përfaqësojnë OSHC-të si dhe hulumtime të zhvilluara me OSHC-të. Në pyetjen nëse “Institucionet përkatëse qeveritare konsultohen me OSHC-të në fazat e hershme të proceseve legjislative ose të politikave (përpara se ato të hartohen në një projekt-dokument)”, në anketën e zhvilluar për raportin PAR Monitor 2021/2022, 48.48% e OSHC-ve përgjigjen në opcionin se “rrallëherë” përfshihen, ndërsa 48.48% të tjerë përgjigjen në opcionin “nganjëherë” përdorur vetëm 7.14% e OSHC-ve theksonjë se ato janë konsultuar “shpesh” në fazat e hershme të konsultimit⁷. Shqetësim i njëjtë është shprehur në pyetjen në lidhje me përfshirjen e OSHC-ve në proces të konsultimit, 64% e tyre shprehen se ata janë përfshirë në proces të konsultimit në kohën kur vështirë mund të japin kontributin e tyre në përmirësimin e dokumentit të konsultuar⁸.

Treguesi i dytë “*numri i OSHC-ve që kontribuojnë në konsultime publike të hapura për draft-politika*” ka për synim të masë shkallën e angazhimit të OSHC-ve në konsultime. Në anën tjetër, një pasqyrë e suksesit të sistemit aktual dhe angazhimeve për konsultimet publike, përveç prezencës në proces, paraqet edhe kontributi që jepet nga OSHC-të në përmirësimin e dokumenteve të konsultuara. Një gjë e tillë, sipas Strategjisë, synohet të matet, përveç tjerash, edhe nga numri i kontributeve që ofrohen nga OSHC-të. Në këtë rast, numri i kontributeve të ofruara nga OSHC-të përmes platformës elektronike në mënyrë kumulative gjatë 5 viteve (nga viti 2019 deri në 2023), ishte 586⁹ (shih figurën 4). Ndërsa synimi ishte që ky numër të arrihej në 350 OSHC që kishin dhënë kontribute deri në vitin 2021, shkalla e arritjes brenda kësaj periudhe ishte 150, ose 43% në krahasim me synimin deri në

6 Kosovo Report 2022, f 13. Shih: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2022_en

7 Weber 2.0, NATIONAL PAR MONITOR KOSOVO 2021/2022 f. 43. Shih <https://www.par-monitor.org/national-par-monitor-2021-2022-kosovo/>

8 Halili, Ruzhdi and Qerkin Berisha. “Public Consultation in Kosovo: Legal Framework, Methods, Tools, and Their Application.” *Hrvatska i komparativna javna uprava* 23, no. 1. (2023): 61-90. Faqe. 80.

9 Numri i komenteve të ofruara nga OSHC-të të dhëna përmes platformës elektronike është pothuajse identik me numrin e përgjithshëm të ofruar në platformë nga të gjitha palët e interesuara.

vitin 2021 (shih figurën 4). Numri 274 i kontributeve të ofruara gjatë vitit 2022 tregon një rritje shumëfish më të lartë se viteve të kaluara, ndërsa në vitin 2023 ky numër është 144 (deri në tetor). Platforma është mjeti kryesor përmes të cilit shumica e dokumenteve u nënshtrohen konsultimeve publike. Megjithatë, palët e interesuara, përfshirë edhe OSHC-të, preferojnë që kontributet e tyre t'i ofrojnë përmes formave të tjera të konsultimeve¹⁰. Në pyetjen e shtruar se “cilën metodë të konsultimit publik e konsiderojnë më efektive”, 41.1% e OSHC-ve përgjigjen se metoda më efektive konsiderohet pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në grupe punuese, pastaj me 22.5% vijnë takimet me palët e interesuara, ndërsa përdorimi i platformës, si metodë më e preferuar konsiderohet nga 17.8% e respondentëve.¹¹ Kjo preferencë tregohet edhe nga numri i kontributeve të ofruara nga palët e interesuara qoftë përmes platformës, takimeve, grupeve të punës apo edhe me shkrim në vitet 2019-2022, i cili është 8846¹². Duhet sqaruar se përveç numrit të komenteve të ofruara përmes platformës, të cilat mund të nxjerren nga platforma (shih figurën 4 më poshtë), ndarja e numrit të komenteteve të ofruara përmes metodave tjera, si përmes takimeve, grupeve punuese, konferencave etj., nuk është e mundur të prezantohet në këtë raport pasi në raporte ofrohet vetëm numri i përgjithshëm i komenteve të ofruara përmes të gjitha metodave të konsultimit. Ndërsa duhet theksuar se, përdorimi i metodave tjera përveç platformës, rekomandohet edhe nga Komisioni Evropian¹³.




Figura 4: Numri i OSHC-ve që kanë ofruar kontribute përmes platformës

Burimi: Të dhënat janë nxjerrë me datë 09.12.2023 nga platforma elektronike e konsultimeve publike për secilin vit¹⁴.

Përfshirja e kontributeve që dalin nga procesi i konsultimeve në dokumentet e konsultuara dhe ndikimi i tyre në përmirësimin e këtyre dokumenteve, paraqet një sfidë. Kjo çështje është theksuar, si nga Komisioni Evropian, ashtu edhe nga organizatat e shoqërisë civile. Një nga sfidat kryesore është që kontributet e ofruara nga shoqëria civile shpesh nuk merren parasysh në mënyrë sistematike.

10 Sipas nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr.05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik format e konsultimit Format dhe teknikat e konsultimit publik përfshijnë, por nuk kufizohen në: 1.1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike; 1.2. Publikimi në ueb faqe; 1.3. Takimet publike; 1.4. Konferencat; 1.5. Takime me grupe të interesit; 1.6. Punëtoritë; 1.7. Intervistat/takimet sy në sy; 1.8. Hulumtimet e opinionit; 1.9. Votimi diskutues; 1.10. Panelet me qytetarë; 1.11. Stendat në rrugë. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15036>

11 Halili, Ruzhdi and Qerkin Berisha. “Public Consultation in Kosovo: Legal Framework, Methods, Tools, and Their Application.” Hrvatska i komparativna javna uprava 23, no. 1. (2023): 61-90. Faqe. 78.

12 Të dhënat janë nxjerrë dhe llogaritur nga raportet vjetore për konsultimet publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës për vitet 2019, 2020, 2021, 2022. Shih: <https://konsultimet.rks-gov.net/documents.php>

13 European Commission Report on Kosovo 2023 f. 10. Shih: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SĚD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf

14 Shih: <https://konsultimet.rks-gov.net/statistics.php>

Në shumë raste, ofruesit e kontributeve nuk informohen në mënyrë sistematike për këtë çështje. Nga pesë dokumentet e testuara nga OECD/SIGMA, raporti i konsultimit është bërë publik vetëm për tre prej tyre, edhe pse janë marrë komente në të pesë rastet.¹⁵

Vlerësimi i efektivitetit për objektivat specifike

Në vijim synohet që fokusi të vihet në vlerësimin e efektivitetit të secilit objektiv specifik, duke filluar nga gjendja në arritjen e synimeve të treguesve për secilin objektiv.

Objektivi specifik 1. Përmirësimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuar në procesin e konsultimeve publike synohet të vlerësohet përmes dy treguesve. Sipas treguesit të parë “*numri i personelit relevant në ZKM, në ministritë e linjës dhe Komuna të trajnuar në zbatim të standardeve minimale për procesin e konsultimit publik*”, deri në vitin 2021 ishin paraparë të trajhohen 150 zyrtarë në ZKM, në ministritë e linjës dhe komuna. Gjatë kësaj periudhe, gjithsej janë trajnuar 146 zyrtarë në nivel qendror dhe lokal (figura 5). Ndërsa deri në vitin 2023 janë trajnuar gjithsej 194 zyrtarë në të gjitha nivelet e qeverisjes.¹⁶ Këtu përfshihen trajnimet e ofruara përmes formave klasike të trajnimit, të ofruara me mbështetjen e projekteve të donatorëve (sidomos nga mbështetja e BE-së) dhe ato të ofruara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike, si dhe ofrimi i mentorimit dhe këshillimit të vazhdueshëm të ofruar për zyrtarët përgjegjës për proceset e konsultuara nëpër ministri.




Figura 5: Numri i zyrtarëve të trajnuar për standardet minimale 2019-2023

Burimi: Të dhënat e ofruara nga Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit.

Me qëllim të zbatimit të aktiviteteve të parapara në kuadër të këtij objektivi, Plani i Veprimit kishte paraparë që të publikohej raporti i trajnimeve të mbajtura për ofrimin e njohurive mbi platformën për standardet minimale për konsultime me publikun. Në raportin e monitorimit për periudhën 2019-2021, Platforma CiviKos kishte evidentuar se raporti për trajnimet për vitin 2020 nuk ishte publikuar nga IKAP. Si rezultat, gjatë vitit 2022 IKAP ka publikuar raportin për trajnimet për vitin 2020. Gjatë vitit 2022, Platforma online për konsultimin publik është avancuar, duke lehtësuar qasjen në dokumentet në konsultim publik për personat me nevoja të veçanta. Më konkretisht, ka

¹⁵ OECD/SIGMA Monitoring report on Kosovo 2021: <https://sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Kosovo.pdf>

¹⁶ Të dhënat për trajnimet sipas kërkesës janë ofruar nga Zyra për Qeverisje të Mirë, përmes emailit të dërguar me datë 18.10.2023

filluar publikimi i videove të cilat përmbajnë përmbledhjen e dokumenteve për personat e shurdhër, me vështirësi në të dëgjuar dhe personat e verbër. Ky është aktivitet shtesë i realizuar pasi nuk ka qenë specifikisht i planifikuar në kuadër të aktivitetit që përfshinë avancimin e platformës. Ndërsa publikimi i raporteve vjetore të konsultimit publik në platformën elektronike të konsultimeve tashmë është bërë praktikë që zbatohet me rregull.

Sfidë në zbatimin e këtij objekti specifik mbetet rekrutimi i zyrtarit për koordinimin e procesit të konsultimeve me publikun dhe publikimi i praktikave më të mira të konsultimit publik me institucionet.

Treguesi i dytë “*niveli i përputhshmërisë të hartimit të politikave dhe legjislacionit të jetë linjë të plotë me Standardet Minimale për konsultime publike deri në vitin 2021*” (bazuar në raportimin e qeverisë për mbështetjen e drejtpërdrejtë të buxhetit të RAP) ka arritur në 77% ndërsa synimi deri në vitin 2021 ishte që ky nivel të arrihet në shkallën 100% (figura 6). Për vitin 2022 mungojnë të dhënat për përputhshmërinë e hartimit të politikave dhe legjislacionit me standardet minimale sipas kriterëve të Programit të BE-së për Mbështetje Buxhetore¹⁷. Shkalla e zbatimit për të gjitha dokumentet e konsultuara për vitin 2022 është 74%¹⁸. Një sfidë për nivelin e zbatimit të standardeve minimale për procesin e konsultimit është vlerësuar edhe nga OECD/SIGMA në raportin e vitit 2021 i cili thekson se rregulloret dhe procedurat për zhvillimin e konsultimeve publike ekzistojnë, por ato nuk ndiqen vazhdimisht në praktikë¹⁹.




Figura 6: Shkalla e plotësimit të standardeve minimale 2022. Burimi: Raporti vjetor për konsultimet me publikun në Qeverinë e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

Në shërbim të avancimit të Platformës Online për Konsultime me Publikun, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë ka punuar në përmirësimin e funksionalitetit të përgjithshëm të saj, me theks të veçantë në qasjen e personave me aftësi të kufizuara (personave të shurdhër dhe të verbër) në këtë platformë.²⁰ Gjithashtu ZQM tashmë është duke punuar në krijimin e aplikacionit mobil të platformës, gjë që nuk ka qenë specifikisht e planifikuar në kuadër të aktivitetit që përfshinë avancimin e platformës.²¹

17 Marrëveshje Financiare për IPA 2016 Pjesa e Dytë Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15707>

18 Raporti për konsultimet publike 2022 <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-645b4128e5f52.pdf>

19 OECD/SIGMA Monitoring report on Kosovo 2021: <https://sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Kosovo.pdf>

20 Informatat e ofruara nga Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë z. Habit Hajredini dhe Zyrtarja e Lartë e kësaj Zyre znj. Trendelina Dreshaj, në takimin e zhvilluar me 17.10.2023.

21 CIVIKOS, Raport i Monitorimit Zbatimi i Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 Këndvështrim i Sekretariatit të Platforma Civikos Prishtinë, tetor 2023/2023. f. 14.

Objektivi specifik 2 synon ngritjen e njohurive të qytetarëve dhe shoqërisë civile për konsultimet publike. Ky objektivi ishte i mbështetur nga dy tregues. Për treguesin e parë *“rritja e numrit të organizatave të shoqërisë civile të regjistruara në Platformën Online”* nuk janë ofruar informatat e kërkuara nga Zyra për Qeverisje të Mirë.

Ndërsa treguesi i dytë i cili ngërthen në vete shumë komponentë është *“rritja e numrit të qytetarëve individual për të dhënë komente në Platformën Online”*. Rritja e numrit dhe qytetarëve në takime publike, komente të dërguara nga qytetarët, komente të adresuara, perceptim të OShC-ve mbi përfshirjen dhe ftesat për konsultim publik. Gjatë viteve 2019-2023, niveli i angazhimit të palëve të interesuara në ofrimin e kontributeve të tyre gjatë procesit të konsultimeve, sipas shifrave zyrtare të raportuara, është rritur në mënyrë graduale, por jo në masën e synuar me Strategji. Shkalla e angazhimit përmes formave tradicionale të konsultimit, si takime dhe konferenca, paraqet një numër më të lartë të pjesëmarrjes, ndërsa krahasuar me këtë, shënohet një numër më i ulët i kontributeve në përdorimin e platformës elektronike.

Gjatë kësaj periudhe (2019-dhjetor 2023), janë dhënë 586 komente për të gjitha dokumentet që janë publikuar për konsultim në platformën elektronike nga institucionet e nivelit qendror të qeverisjes.²² Në vitin e parë të zbatimit të Strategjisë, numri i komenteve të ofruara ishte shumë i ulët, duke arritur vetëm në 41 komente përmes platformës elektronike. Megjithatë, gjatë vitit të tretë të zbatimit të Strategjisë (2021), numri i komenteve është rritur, ndërsa gjatë vitit 2022 ky numër është shumëfishuar, duke arritur në 274 komente (shih figurën nr. 7).

Megjithatë, vlerësohet se numri i komenteve të ofruara përmes platformës gjatë viteve të vlerësimit ishte shumë i ulët në raport me synimin (synohej që në vitin 2023 të arrihej numri 5000 i komenteve në platformë). Gjithashtu, ky numër është shumë më i ulët në krahasim me numrin e komenteve të ofruara përmes metodave tjera të konsultimit - takime, konferenca, etj. (shih figurën 7 më poshtë).




Figura 7: Burimi: Platforma elektronike e konsultimeve dhe raportet vjetore të konsultimeve 2019-2022

Ndërsa, aktiviteti i pazbatuar në kuadër të këtij objektivi mbetet publikimi i Strategjisë së komunikimit me publikun mbi Platformën online dhe standardet e konsultimeve publike, pasi një dokument i tillë tashmë është përgatitur.

22 Të dhënat janë nxjerrë me datë 09.12.2023 nga platforma elektronike e konsultimeve publike për secilin vit. Shih: <https://konsultimet.rks-gov.net/statistics.php>

Objektivi specifik 3 synon përmirësimin e kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuar në procesin e konsultimeve publike. Ky objektivi mbështetet nga treguesi “numri i OSHC-ve të trajnuara në procesin e politikëbërjes dhe përdorimin e Rregullores dhe Platformës Online”. Progresi në arritjen e objektivit të tretë specifik ka qenë i mangët. Është raportuar se KCSF, nëpërmjet Qendrës së Burimeve për Shoqëri Civile, ka ofruar trajnime dhe sesione informuese për shoqërinë civile lidhur me shfrytëzimin e mekanizmave formal për pjesëmarrje qytetare. Megjithatë duke qenë se as gjatë vitit 2022 asnjë nga sesionet informuese për rritjen e kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuar në procesin e konsultimit publik nuk janë mbajtur, ngecje në zbatimin e aktiviteteve të këtij objektiv vazhdon të mbetet mbajtja e këtyre sesioneve. Sesionet informuese do të rezultojnë në përgatitje më të madhe të organizatave që e përcjellin procesin e konsultimeve publike e rrjedhimisht përmirësim të këtij procesi.

Çfarë vlen të theksohet është se organizata jo-qeveritare Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar (CEA) në Kosovë punon aktivisht për të përmirësuar dhe forcuar qeverisjen lokale në Kosovë. Më saktësisht, ata kanë përpiluar Metodologjinë e Monitorimit të Konsultimit Publik në Komuna e cila iu shërben individëve dhe organizatave të monitorojnë dhe raportojnë për gjithëpërfshirje dhe transparencën e vendimmarrjes në nivelin lokal. Metodologjia ka pikënisje Udhëzimin Administrativ 06/2008 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna dhe Doracakun për Konsultime Publike në Komuna dhe përshkruan dhe zbërthen procesin që duhet të zbatohet në nivelin lokal. Për më shumë, KLGJ ka trajnuar 20 trajnere dhe trajnerë të cilët janë të gatshëm të angazhohen në përmirësimin e kapaciteteve të OSHC-ve për të monitoruar dhe marrë pjesë në politikë-bërje në nivelin lokal.²³

Përmbledhje e zbatimit të aktiviteteve

Nga gjithsej 13 aktivitetet e planifikuara për arritjen e objektivit të parë për rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje, 8 aktivitete janë zbatuar plotësisht, 1 është pjesërisht i zbatuar, 2 janë në proces të zbatimit ndërsa 2 nuk janë zbatuar fare. Më konkretisht, mbi 61% e aktiviteteve janë zbatuar plotësisht, mbi 7% janë pjesërisht të zbatuara, mbi 15% janë në proces të zbatimit, ndërsa mbi 15% nuk janë zbatuar (shih figurën nr. 8 më poshtë).



Figura 8: Statusi i zbatimit të aktiviteteve për objektivin e parë strategjik. Burimi: Raporti i Monitorimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 për vitin 2022. Civikos. 2023.

23 CIVIKOS, Raport i Monitorimit: Zbatimi i Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 - Këndvështrim i Sekretariatit të Platforma Civikos. Prishtinë, tetor 2023. f. 15

Vlerësimi i efikasitetit

Vlerësimi i efikasiteti të Strategjisë është bërë duke ju përgjigjur pyetjeve: A janë ndarë burime të mjaftueshme për arritjen e objektivave strategjike? Çfarë burimesh plotësuese do të jenë të nevojshme për një zbatim më efikas?

Një nga sfidat në vlerësimin e efikasitetit të zbatimit të Strategjisë është mungesa e ndërlidhjes së buxhetit të kostuar në planin e Strategjisë me buxhetin e Qeverisë, si në planifikim të buxhetit ashtu edhe në shpenzime. Në anën tjetër, është vërejtur se vlerësimi i kostos së zbatimit të Strategjisë duhej të ishte më përmbajtësor, real dhe më i qartë.

Një numër aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve civilë, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e platformës elektronike për konsultimet publike, si dhe aktivitete promovuese të tjera, janë mbështetur nga Projekti i BE-së "Support to the Implementation of the Government Strategy for Cooperation with Civil Society," i cili ka përfunduar në vitin 2020. Përfundimi i këtij projekti është pasuar me angazhim nga vet institucionet përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë, duke përfshirë aktivitete që në shumicën e rasteve janë pjesë e punës së tyre të përditshme. Kjo lidhet sidomos me punën koordinuese të ZQM-së, zhvillimin e proceseve konsultuese nga ministritë dhe veçanërisht organizimin e trajnimeve për temat e konsultimeve nga IKAP-i.

Përveç kësaj, disa projekte nga donatorë të tjerë, si OSBE dhe BE përmes projektit TACSO, që tashmë është në zbatim e sipër, kanë vazhduar me projekte dhe në masë të madhe do të plotësojnë nevojat e mbështetjes teknike në vitet e ardhshme. Megjithatë, informacioni i detajuar në lidhje me shumata buxhetore të alokuara dhe të shpenzuara për aktivitetet që lidhen me konsultimet publike, si dhe efikasitetin e shpenzimeve, është e pamundur të identifikohet për shkak të natyrës së aktiviteteve të parapara, mungesës së ndërlidhjes së buxhetit të planifikuar qeveritar me aktivitetet e zbatuara në kuadër të Strategjisë etj.

Relevanca

Vlerësimi i Relevancës së objektivave është bërë duke ju përgjigjur pyetjeve: Deri në çfarë mase Strategjia ka qenë relevante në funksion të nevojave aktuale në Kosovë? Deri në çfarë mase Strategjia ka qenë e rëndësishme në aspektin e përmbushjes së kërkesave për pranim në BE?

Është konfirmuar se objektiva strategjike e cila ka për qëllim rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikëbërje ka pasur relevancë dhe siguron vazhdimësinë në planifikim strategjik për fushën e konsultimeve publike edhe për ciklin e ardhshëm planifikues. Përveç kësaj, relevanca dhe rëndësia e objektivave specifike nuk është vënë në diskutim nga ana e palëve të involvuara në zbatimin e kësaj Strategjie. Gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë, ka pasur disa iniciativa dhe aktivitete të cilat kanë përmirësuar procesin e konsultimit, e të cilat nuk ishin paraparë me strategjinë aktuale. Këtu veçanërisht përmendet zgjerimi i platformës për përdorim në nivel komunal dhe zbatimi i standardeve minimale të konsultimit publik në nivel komunal si dhe moduli i cili mundëson qasjen e personave me aftësi të kufizuara në platformë. Prandaj, këta faktorë duhet të merren parasysh gjatë përcaktimit të fushëveprimit të objektivave strategjike për periudhën e ardhshme planifikuese në këtë fushë.

Vlerësohet se niveli i instrumenteve për matjen e progresit, si treguesit apo targetet, kanë nevojë që të kenë mbulueshmëri më të mirë të fushëveprimit të objektivave, si dhe përveç matjes kuantitative, të sigurojnë edhe mundësinë për matje kualitative të arritjes së objektivave. Strategjia, një fokus të veçantë i kishte kushtuar përmirësimit të procesit të konsultimeve përmes platformës, gjë që ka shkaktuar përqendrim më të madh të raportimit të aktiviteteve dhe informatave për konsultimet që janë bërë përmes platformës. Në shumicën e rasteve synimet (targetet) e vendosura kanë qenë

tepër ambicioze, dhe në shumë raste të ndërtuara në mënyrë jo të duhur. P.sh. treguesi 2 i objektivit specifik 1.2 *Rritja e numrit të qytetarëve individual për të dhënë komente në Platformën Online. Rritja e numrit dhe qytetarëve në takime publike, komente të dërguara nga qytetarët, komente të adresuara, perceptim të OShC-ve mbi përfshirjen dhe ftesat për konsultim publik.* Ky tregues përfshinë disa variabla të matjes së progresit si: komentet e ofruara në platformë, pastaj komente të dërguara në takime publike, ato të adresuara, aspektet e perceptimit të OShC-ve, etj. Nga ky përshkrim i treguesit mund të nxjerren disa të tillë, ndërsa, synimet përfshijnë vetëm komentet e ofruara (megjithëse gjithashtu nuk është e qartë nëse në këtë rast synohet të bëhet matja e kontributeve të ofruara përmes platformës apo synimet përfshijnë të gjitha kontributet, përmes të gjitha formave të konsultimit, nga të gjitha palët e interesuara apo vetëm nga OShC-të). Kjo në realitet e bën pothuajse të pamundur vlerësimin e arritjes së objektivit.

Në kuadër të mundësisë së avancimit të fushëveprimit dhe kornizës strategjike për ciklin e ardhshëm planifikues, pa hyrë në detaje të objektivave specifike, udhëzimet e ofruara nga Drejtoria e Zgjerimit përmes “Udhëzuesit për Mbështetje të BE për Shoqërinë Civile në Rajonin e Zgjerimit 2021-2027”²⁴ ofrojnë një referencë të fuqishme dhe bazë që mund të ndihmojë në vendosjen e kornizës së ardhshme dhe objektivave për fushën e konsultimeve publike.

Një segment tjetër që ndikon në vlerësimin e duhur të zbatimit të Strategjisë është fakti që plani për zbatimin e Strategjisë i cili mbulonte periudhën 2019-2021 është vazhduar pa pasur një proces të rishikimit të tij dhe përditësimit të afateve dhe synimeve dhe si rezultat, vlerësimi bëhet duke u bazuar në synimet e vendosura për vitin 2021 të cilat me automatizëm ishin vazhduar²⁵.

Ndikimi

Vlerësimi i ndikimit të zbatimit të Strategjisë bëhet duke ju përgjigjur pyetjeve: Çfarë ka ndodhur si rezultat i Strategjisë? Çfarë ndryshimi ka bërë Strategjia për grupet e ndryshme të përfituesve (dhe për publikun e gjerë në përgjithësi)? Si janë prekur grupet e ndryshme të synuara?

Miratimi i Rregullores për Standardet Minimale për Konsultimet Publike, vënia në përdorim e platformës së konsultimeve nga viti 2017 e tutje, ka përbërë një hap përmbajtësor për përmirësimin e procesit të konsultimeve publike. Kjo ka ndikuar që shkalla e dokumenteve të konsultuara të arrijë në vazhdimësi në mbi 90%.

Gjatë periudhës të cilën e mbulon Strategjia (2019-2021), statistikat tregojnë se trendi i përmirësimit të pjesëmarrjes së shoqërisë civile por edhe publikut në tërësi, në procesin e vendimarrjes ka qenë gradual pas vitit 2019. Ajo që vërehet është se viti 2020 ka shënuar rënie në statistikat e prezantuara për shumicën e treguesve. Kjo tregon se Pandemia COVID-19 ka pasur një ndikim të theksuar. Nga një hulumtim i zhvilluar me OShC-të gjatë vitit 2022, shumica e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSC) konsiderojnë se COVID-19 ka pasur një ndikim në konsultimet publike të kryera nga Qeveria. Kur janë pyetur nëse COVID-19 kishte ndikuar në cilësinë e konsultimeve publike, 65.2% e përgjigjeve konsideronin se COVID-19 kishte ndikuar negativisht në procesin e konsultimit²⁶. Megjithatë, elementi E10. *Ndikimi i rezultateve të konsultimit publik në hartimin e politikave* i treguesit “*Perceptimi i shoqërisë civile dhe shtrirja e përfshirjes në politikëbërje*” të Raportit të

24 DG NEAR Guidelines for EU Support to Civil Society in the Enlargement Region 2021-2027, shih në: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/EU-Guidelines-for-Support-to-Civil-Society-in-the-Enlargement-region-2021-2027.pdf>

25 Vazhdimi i Planit të Veprimit të Strategjisë sipas ZQM-së është bërë me automatizëm deri në vitin 2023. Por një vendim për statusin e tij nuk është marrë nga ana e Qeverisë.

26 Halili, Ruzhdi and Qerkin Berisha. “Public Consultation in Kosovo: Legal Framework, Methods, Tools, and Their Application.” *Hrvatska i komparativna javna uprava* 23, no. 1. (2023): 61-90. <https://doi.org/10.31297/hkju.23.1.4>, f. 83.

monitorimit të Weber-it kishte marrë 2/2 pikë²⁷. Edhe pse ndikimi i proceseve të konsultimeve kërkon një analizë të thellë dhe një distancë kohore nga momenti i zbatimit, ka shumë raste të konsultimeve të zhvilluara nga institucionet që mund të shërbejnë si referenca për praktikën e mira të konsultimeve publike. Në këtë kontekst, mund të përmendet procesi i konsultimit i zhvilluar për Koncept Dokumentin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, menaxhuar nga Minsitria e Administrimit të Pushtetit Lokal²⁸.

Qëndrueshmëria

Vlerësimi i ndikimit të rezultateve të Strategjisë bëhet duke ju përgjigjur pyetjeve: A do të vazhdojnë përfitimet pas zbatimit të Strategjisë? A mund të jenë ndikimet afatgjata? Çfarë mund të bëhet për të siguruar që ato të mbeten të qëndrueshme?

Themelimi i sistemit të konsultimeve, nga të gjitha palët e interesuara, si dhe nga Komisioni Evropian, është vlerësuar si një hap reformues i rëndësishëm në procesin e politikëbërjes dhe hartimit të legjislacionit në Kosovë. Megjithatë, me kalimin e kohës, sidomos periudhën që mbulon Strategjia, është vlerësuar se nevojat dhe dinamika e proceseve kanë evoluuar, ndërkohë që shumë sfida janë paraqitur gjatë këtij procesi, sidomos pas finalizimit të kornizës ligjore e cila është vlerësuar pozitivisht dhe instrumenteve të monitorimit, siç është platforma elektronike. Megjithatë, edhe pse statistikën tregojnë se për zbatimin e standardeve minimale, në shumë segmente të konsultimit kanë shënuar trende pozitive, vlerësimi nga ana e palëve të interesit se procesi i konsultimeve është duke u zbatuar për të përmbushur kriteret formale, është rritur²⁹. Kjo nënkupton që duhet ruajtur dhe rritur besimin që konsultimet e zhvilluara bëhen për të arritur qëllimet për një qeverisje të mirë. Prandaj, sigurimi i qëndrueshmërisë së sistemit dhe procesit të konsultimit kërkon përkushtim më të madh në zbatimin më të madh dhe më përmbajtësor të rregullativës së miratuar, e përveç kësaj sidomos në monitorim dhe kontroll të kualitetit të konsultimeve të mbajtura nga ministritë. Në këtë kontekst OECD/SIGMA në raportin e monitorimit të vitit 2021 thekson se problemi kryesor është se kontrolli i cilësisë nuk zbatohet në mënyrë sistematike në praktikë. Përveç kësaj, për të siguruar qëndrueshmëri të tij duhet të adresohen shqetësimet e përdoruesve dhe përfituesve të procesit si dhe për të garantuar efektivitetin e procesit të konsultimit.

Tabela e treguesve

Vlerësimi i zbatimit të objektivit të parë strategjik bëhet përmes treguesve dhe synimeve të përcaktuara në Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 dhe planin e zbatimit të saj. Rezultatet e arritura gjatë periudhës së vlerësimit janë paraqitur në vijim:

Tabela 1: Statusi i arritjes së synimeve për objektivin e parë strategjik - Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje.

27 Weber 2.0, NATIONAL PAR MONITOR KOSOVO 2021/2022 f. 43. Shih <https://www.par-monitor.org/national-par-monitor-2021-2022-kosovo/>

28 Intervista me Dren Puka, KCSF, shih gjithashtu <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41689> si dhe <https://mapl.rks-gov.net/nees/mbahet-takimi-publik-per-koncept-dokumentin-per-dhenien-ne-shfrytezim-dhe-kembimin-e-prones-komunale/?cptadid=143>

29 Një konstatim i tillë rrjedhë si nga hulumtimet që janë bërë me OJQ-të, të cilat janë referuar në këtë raport, ashtu edhe nga shumë palë të intervistuar nga shoqëria civile për qëllim të këtij vlerësimi (shih shtojcën 2).

Objektivit Strategjik 1: Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje				
Treguesi	Vlera bazë	Synimi final (viti 2021)	Arritja 2021	Arritja 2023
Numri i OSHC-ve të përfshira në ekipet e punës për hartimin e politikave të reja dhe fazat e hershme të zhvillimit të legjislacionit	50 OSHC	150 OSHC	225 Është arritur	1109 Është arritur
Numri i OSHC-ve që kontribuojnë në konsultime publike të hapura për draft-politika	100 OSHC	350 OSHC	150 OSHC Pjesërisht i arritur	568 I arritur
Objektivi specifik 1.1.: Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve për zbatimin e standardeve minimale për konsultimet me publikun				
Numri i personelit relevant në ZKM, në ministritë e linjës dhe Komuna të trajnuar në zbatim të standardeve minimale për procesin e konsultimit publik	50	150	146 Pjesërisht i arritur	194 I arritur
Niveli i përputhshmërisë të hartimit të politikave dhe legjislacionit të jetë në linjë të plotë me Standardet Minimale për konsultime publike deri në vitin 2021 (bazuar në raportimin e Qeverisë për mbështetjen e drejtpërdrejtë të buxhetit të RAP)	30%	100%	77.27% Pjesërisht i arritur	Nuk ka informata për SBS 74% plotësimi i standardeve për të gjitha dok. e konsultuara
Objektivi specifik 1.2.: Ngritja e njohurive të qytetarëve dhe shoqërisë civile për konsultimet publike				
Rritja e numrit të organizatave të shoqërisë civile të regjistruara në Platformën Online	151 OSHC	100% 500 OSHC të abonuar në platformën online	Nuk ka informata	Nuk ka informata
Rritja e numrit të qytetarëve individual për të dhënë komente në Platformën Online Rritja e numrit të qytetarëve në takime publike, komente të dërguara nga qytetarët, komente të adresuara, përceptim të OSHC-ve mbi përfshirjen dhe ftesat për konsultim publik	1119 komente	100% 5000 komente në platformën online	586 komente gjatë 01.01.2019 deri 9.12.2023 Pjesërisht i arritur	Pjesërisht i arritur
Objektivi specifik 1.3: Përmirësimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuar në procesin e konsultimeve publike				
Numri i OSHC-ve të trajnuara në procesin e politikbërjes dhe përdorimin e Rregullores dhe Platformës Online	100 OSHC	300 OSHC	Nuk ka informata	Nuk ka informata

2.2 OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: PËRMIRËSIMI I KORNIZËS INSTITUCIONALE DHE LIGJORE PËR FINANCIM NË ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË PROGrameve dhe projekteve të OSHC-ve me interes publik

Vlerësimi i efektivitetit

Vlerësimi i efektivitetit të zbatimit të Strategjisë sa i përket këtij objektivi strategjik është bërë duke ju përgjigjur pyetjeve në vijim: Deri në çfarë mase janë arritur objektivat? Cilat kanë qenë rezultatet e realizuara në raport me objektivat specifike? Deri në çfarë mase janë zbatuar veprimet/masat e Planit të Veprimt?

Në kuadër të objektivit strategjik **“Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OShC-ve me interes publik”**, ishte përfshirë një tregues që ka për qëllim të masë rezultatin e synuar në kuadër të kësaj objekteve *“Përqindja e institucioneve që kryejnë thirrje publike për financimin e OSHC-ve në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OSHC-ve”*. Megjithatë, vërejmë se ky tregues mbulon vetëm njërin nga 4 objektivat specifike në kuadër të objektivës strategjike, atë mbi standardet e financimit publik të OSHC-ve, ndërsa tre objektivat tjera specifike, nuk janë të mbuluara me këtë tregues. Rrjedhimisht, do të jetë e pamundur të bëhet një vlerësim i përgjithshëm i kësaj objekteve, duke u bazuar vetëm në këtë tregues, prandaj duhet të analizohen të gjithë treguesit në kuadër të objektivave specifike për të nxjerrë një konkluzion sa i përket efektivitetit të saj. Përveç kësaj, treguesi dhe rezultati i synuar kanë disa paqartësi në mënyrën e formulimit, duke krijuar një dilemë nëse ky tregues duhet të vlerësojë faktin nëse institucionet kanë hapur thirrje publike për financimin publik të OSHC-ve, apo vlerësimi duhet shkojë përtej kësaj, duke vlerësuar nëse thirrjet e hapura janë në përputhje me kriteret e rregullores për financimin e projekteve të OSHC-ve. Prandaj, në rastin konkret treguesi duhet të përfshijë të dy aspektet: nëse financimi ka ndodhur përmes thirrjeve dhe nëse thirrjet janë në përputhje të plotë me Rregulloren MF. Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OSHC-ve.

Nga analiza e Raporteve Vjetore të Zbatimit të Strategjisë³⁰, shihet se për një numër të madh të treguesve, përfshirë ata në kuadër të kësaj objekteve strategjike mungojnë të dhënat sa i përket rezultateve në nivel të treguesve që mbulojnë gjithë periudhën e zbatimit të Strategjisë. Disa nga raportet vjetore përmbajnë të dhëna më të sakta, por në raportet e viteve të fundit vërehet mungesë e të dhënave të tilla.³¹ Kjo e vështirëson kryerjen e një vlerësimi të saktë të të gjithë objektivit. Prandaj, për vlerësimin e këtij indikator, janë analizuar Raportet vjetore të Financimit Publik të OSHC-ve, të përgatitura nga Zyra për Qeverisje të Mirë, dhe të dhënat e raportuara në Platformën e Financimit Publik të OSHC-ve³². Janë analizuar disa raporte të Auditimit të Pasqyrave Financiare të disa Organizatave Buxhetore për të parë nëse ekzistojnë gjetje të Zyrës Kombëtare të Auditimit sa i përket financimit të projekteve të OSHC-ve. Përveç kësaj, si bazë për të bërë një vlerësim të këtij treguesi kanë shërbyer edhe intervistat me përfaqësues të OSHC-ve dhe institucioneve publike të cilat kanë shërbyer për të nxjerrë konkluzionet lidhur me treguesit e vendosur në kuadër të kësaj objekteve. Përveç kësaj, në vitin 2021, Zyra Kombëtare e Auditimit ka publikuar një Raport të auditimit të performancës: *Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave jo-qeveritare*³³, i cili identifikon sfidat në procesin e financimit publik të OSHC-ve.

30 <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/03/Raporti-per-zbatim-te-Strategjise-dhe-planit-te-veprimit-per-bashkepunim-te-Qeverise-me-Shoqer-Civile-per-vitin-2022.pdf>

31 P.sh. në raportin vjetor të vitit 2019 ekzistojnë të dhëna shumë më të sakta sa u përket treguesve të performancës. Njëri nga faktorët që mund të ketë ndikuar është edhe përkrahja që ZQM/ZKM ka pranuar gjatë asaj periudhe në zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë por edhe në ofrimin e përkrahjes në përgatitjen e raporteve vjetore.

32 <http://ojqfinancime.rks-gov.net/>.

33 Zyra Kombëtare e Auditimit, RAPORTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS: Transparenca dhe llogaridhënia në procesin

Në këtë kontekst janë analizuar disa thirrje publike, përgjatë viteve të zbatimit të Strategjisë, kryesisht në institucionet që kanë ofruar më shumë mbështetje financiare publike për OSHC-të, duke përfshirë:

- Komuna e Pejës;
- Komuna e Prishtinës;
- Komuna e Gjilanit;
- Komuna e Prizrenit;
- Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- Zyra e Kryeministrit;

Nga gjithë analiza e dokumenteve të përmendura më sipër, mund të nxirren përfundimet si në vijim:

- Institucionet publike të nivelit qendror dhe komunal pothuajse në tërësi ofrojnë mbështetje financiare publike për OSHC-të përmes thirrjeve publike. Në këtë drejtim është evidentuar përmirësim i dukshëm përgjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë, sa i përket kualitetit të thirrjeve publike për financim të projekteve të OSHC-ve dhe ofrimit të mbështetjes financiare publike për OSHC-të në përputhje me kërkesat e Rregullores MF. Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OSHC-ve.³⁴
- Pavarësisht përmirësimit të theksuar të zbatimit të kriterëve të Rregullores MF. Nr. 04/2017 në procesin e Financimit Publik të OSHC-ve, ende paraqiten sfida, të identifikuar si në vijim:
 - Nga disa prej thirrjeve publike të hapura në vitin 2021, por edhe ato të vitit 2022 dhe 2023, ekzistojnë paqartësi, të cilat referuar MF. Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OSHC-ve, nuk do duhej të ekzistonin. Në disa raste ka pasur thirrje publike të cilat janë anuluar, për shkak të mospërputhshmërisë së tyre me kërkesat e rregullores, apo shkaqe tjera të identifikuar gjatë procesit të zbatimit.
 - Gjithashtu, vlerësimi i projekteve në të paktën disa raste, si dhe publikimi i rezultateve nuk ka qenë në përputhje me kërkesat e rregullores. Në një rast vërehet se me rastin e publikimit të rezultateve, rezultatet dhe pikët janë publikuar edhe për OSHC-të që nuk janë përfituese, që është në kundërshtim me kërkesat e rregullores.³⁵ Është vërejtur edhe ofrimi i një shume shumë më të vogël të financimit se sa shuma me të cilën ka aplikuar OSHC përfituese, pa i reduktuar aktivitetet e projekteve, dhe pa arsyetime përkatëse pse një financim i tillë është reduktuar, që po ashtu është në kundërshtim me kërkesat e rregullores dhe manualit për zbatimin e saj.³⁶ Ka pasur raste që nuk janë aplikuar kërkesat e thirrjes publike ndaj aplikantëve (komuna e Prizrenit 2020).³⁷ Megjithatë, raporti i vitit 2021, i Zyrës Kombëtare të Auditimit tregon përmirësim në implementimin e rekomandimeve nga viti paraprak në rastin e Komunës së Prizrenit.³⁸
 - Në përgjithësi ka munguar një proces konsultimi i organizatave buxhetore me OSHC-të në planifikimin e mbështetjes financiare për OSHC-të. Në të njëjtën kohë, në shumë institucione

e financimit të organizatave jo-qeveritare, 2021, https://www.zka-rks.org/ep-content/uploads/2021/07/RAP_FinancimiiOJQ_Shqip.pdf?fbclid=IéAR2gÉgOGénRxecSov8UOJ_Og2g7G64KfPjCcm5rJojEOeb5rKxzZ38A-cé

34 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=14831>

35 Thirrje Publike e Komunës së Prishtinës, 2023.

36 E confirmuar në disa nga intervistat e zhvilluara me përfaqësues të OJQ-ve, gjatë procesit të vlerësimit të Strategjisë.

37 RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2020, f.15, https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/07/RaportiAuditimit_K_PZ_2020_Shqip.pdf

38 RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2021, f.24. https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2022/06/RaportiAuditimit_K_PZ_2021_Shqip-1.pdf

nuk janë publikuar planet vjetore të financimit publik të OSHC-ve.³⁹

- Në disa raste individuale, por të rralla, është bërë financim i projekteve të OSHC-ve pa thirrje Publike.⁴⁰
- Në vitin 2022, 5% e institucioneve publike nuk kanë raportuar në platformën e financimit publik të OSHC-ve⁴¹. Kjo e ka bërë të pamundur për ZQM-në të vlerësojë nëse kanë pasur ose jo thirrje publike, rrjedhimisht ia kanë vështirësuar Zyrës së Kryeminsitrit të vlerësojë zbatimin e përmbushjes së këtij treguesi.
- Mund të konkludohet se në disa raste mungojnë kapacitetet institucionale për të zbatuar thirrjet publike në përputhje me kriteret e rregullores. Këtë konstatim e bën edhe raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2022.⁴² Megjithatë, siç potencon Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023, zbatimi i rregullores për financimin publik të OSHC-ve është gradualisht duke u përmirësuar.⁴³

Objektivi specifik 1: Fuqizimi i kapaciteteve të Ministrive dhe Komunave për zbatimin e standardeve për financimin publik të OSHC-ve. Në kuadër të këtij objekti specifik, si rezultat i prituri deri në fund të vitit 2021 ishte **“trajnimi i 300 shërbyesve civil lidhur me kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OSHC-ve”**. Zyra për Qeverisje të Mirë në ZKM dhe Ministria e Financave, gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë kanë ndërmarrë një sërë veprimesh në përmbushjen e rezultateve të pritura në nivel të këtij treguesi. Një kontribut të konsiderueshëm në ngritjen e kapaciteteve të shërbyesve civil sa i përket kriterëve, standardeve dhe procedurave të financimit publik të OSHC-ve kanë dhënë projektet e asistencës Teknike të Financuara nga BE-së si projekti, *EU TA Project – Support to the implementation of the Government Strategy for Cooperation with Civil Society*, duke ofruar trajnime të përgjithshme, trajnime në vendin e punës, sesione informuese dhe një Trajnim të Trajnerëve në Financimin Publik të OSHC-ve. Përmes këtij Trajnimi të Trajnerëve, janë licencuar nga IKAP 12 shërbyes civil të cilët do të ofrojnë në kuadër të programeve të Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP) trajnime për Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve. Ky kontribut është vazhduar edhe me mbështetjen e projektit TACSO, i cili ka ndihmuar në përmirësimin Platformës së Financimit Publik të OSHC-ve, dhe përmirësimin e koordinimit të procesit të raportimit. Prandaj, zhvillimet kyçe përfshijnë emërimin e zyrtarëve përgjegjës për raportim nga ministritë dhe komunat, sesionet informuese për t’u njoftuar zyrtarët mbi detyrat e tyre dhe procedurat e raportimit, trajnimet në vendin e punës si dhe përgatitjen e një programi trajnimi komplet për certifikimin e 12 trajnuesve në kriteret dhe standardet e financimit publik të OSHC-ve. Përveç kësaj, janë bërë përmirësime substanciale në Platformën e Financimit Publik, e cila mundëson raportimin direkt dhe i ofron publikut njohuri më të thella në lidhje me alokimin e fondeve nga burime publike për OSHC-të. Këto përpjekje reflektojnë një angazhim më të gjerë për promovimin e transparencës dhe efikasitetit në alokimin e fondeve publike për OSHC-të në Kosovë. Përditësimi i platformës me të dhëna të vizualizuara dhe më të sakta ka ndikuar në rritje të transparencës.⁴⁴ Raporti Vjetor i zbatimit të Strategjisë për Vitin 2019, tregon se deri në këtë

39 Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Prishtinës për vitin 2021, f. 4. I qasëm në: https://www.prishtinaonline.com/uploads/raportiauditimit_k_pr_2021_shqip.pdf

40 Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Gjilanit për vitin 2021, f. 10. I qasëm në: https://www.zka-rks.org/ep-content/uploads/2022/05/RaportiAuditimit_K_GL_2021_Shqip.pdf

41 Raporti për zbatim të Planit të Veprimit për Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, periudha e Vlerësimit 2022, f.11.

42 European Commission, Kosovo 2022 Report, f.11. I qasëm në: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>

43 European Commission, Kosovo 2023 Report, f.11. I qasëm në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SĚD_2023_692%20Kosovo%202023%20report.pdf

44 Po aty.

periudhë, ishin trajnuar rreth 135 shërbyes civil, kryesisht përmes projektit të asistencës teknike të financiar nga Zyra e BE-së në Kosovë.⁴⁵

Nga analiza e dokumentacionit që është përdorur për të kryer këtë vlerësim, nga intervistat me Organizata të Shoqërisë Civile dhe akterët tjerë, vlerësohet se janë përmirësuar kapacitetet e institucioneve publike në zbatimin e thirrjeve publike nëse bëjmë një krahasim nga fillimi i zbatimit të Rregullores MF. Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OSHC-ve. Ndonëse mund të vlerësohet se ky tregues është përmbushur në masë të madhe, në mungesë të numrit të saktë të zyrtarëve të trajnuar përgjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë (2019-2021 dhe deri në 2023), mund të vlerësohet si pjesërisht i arritur.

Objektivi Specifik 2: Përmirësimi i kornizës ligjore dhe institucionale për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave. Në kuadër të këtij objektivi specifik, ishin përfshirë tre tregues, të cilët do të mundësonin matjen e rezultateve në kuadër të kësaj objektive. **Treguesi 1 “Aktet e nevojshme ligjore për rregullimin e filantropisë individuale dhe të korporatave të ndryshuara ose të miratuara”.** Si rezultat i pritur deri në fund të vitit 2021 ishte *rishikimi i kornizës ligjore që rregullon fushën e filantropisë individuale dhe të korporatave, duke përfshirë ndryshimin dhe miratimin e tyre.* Megjithatë, nga analiza e raporteve vjetore të zbatimit të Strategjisë,⁴⁶ raporteve monitoruese të përgatitura nga Platforma CIVIKOS⁴⁷, por edhe nga intervistat e realizuara gjatë vlerësimit, është konstatuar se gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë, nuk ka pasur ndonjë zhvillim nga ana e institucioneve përgjegjëse qeveritare që do të konsiderohej se ka përmirësuar kornizën ligjore që mbulon fushën e filantropisë.

Gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë, vërehet se janë ndërmarrë disa iniciativa në veçanti nga ana e shoqërisë civile, kryesisht në nivel të analizave. Në vitin 2019, Forumi për Iniciativa Qytetare kishte publikuar një analizë të titulluar “Analizë Legjislacionit të Kosovës Lidhur me Filantropinë dhe OSHC-të”,⁴⁸ i cili trajtonte në mënyrë gjithëpërfshirëse kornizën ligjore aktuale që mbulon sektorin e OSHC-ve, duke ofruar edhe një analizë krahasuese me vendet tjera në rajon dhe më gjerë, kryesisht sa u përket çështjeve të lehtësirave tatimore dhe sponsorizimeve. Analiza identifikonte disa mangësi dhe/apo kundërthënie në legjislacionin tatimor. Ndonëse ishte diskutuar që kjo analizë të jetë si një pikënisje për një koncept të gjerë që synonte të adresonte çështjet e filantropisë.⁴⁹ Në aspektin ligjor nuk mund të evidentohet se ka pasur ndonjë zhvillim thelbësor që përfshinë fushën e filantropisë që nga kjo periudhë.

KCSF është në proces të zhvillimit të një analize të kornizës ligjore dhe rregullative për filantropinë në Kosovë.⁵⁰ Kjo analizë është duke u zhvilluar nga KCSF në bashkëpunim me European Center for Non-for-Profit Law, në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar (CEA). Analiza synon të ketë qasje gjithëpërfshirëse dhe shumë-shtresore të pengesave kryesore që pengojnë zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave, dhe do të ofrojë praktika krahasuese evropiane,

45 RAPORT VJETOR PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË QEVERTARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2019–2023 PËR VITIN 2019, Qershor 2020, f. 21. I qasshëm në: <https://zqm.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/dokumentet/RAPORTI%20VJETOR%20P%C3%8BR%20STRATEGJIN%C3%8B%202019-TD.pdf>

46 Raporti për zbatim të Planit të Veprimit për Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, periudha e raportimit 2022; Raporti për zbatim të Planit të Veprimit për Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, periudha e Raportimit, 2021.

47 Raportet monitoruese Civikos, Raport i Monitorimit Zbatimi i Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 Këndvështrim i Sekretariatit të Platforma Civikos Prishtinë, tetor 2023. I qasshëm në: https://civikos.net/wp-content/uploads/2023/10/Raporti-3_compressed.pdf.

48 Forumi për Iniciativa Qytetare, Analizë Legjislacionit të Kosovës Ligjor me Filantropinë dhe OJQ-të, 2019. I qasshëm në: https://fiq-fci.org/file/repository/fiq-fci.org/Analize_legjislacionit_te_Kosoves_per_filantropi_dhe_OJQ.pdf

49 Po aty, f. 9.

50 Intervistë me Dren Puka, KCSF, 11.10.2023.

duke propozuar edhe zgjidhje specifike për çështjet e identifikuar. Analiza mund të shërbejë si bazë për të nisur dialog politikash që promovon kulturë të dhurimeve individuale për kauza të së mirës publike. **Treguesi 2 “Numri i zyrtarëve të tatimit të trajnuar në praktikat për administrimin e përfitimeve në tatime për filantropi”**. Deri në fund të vitit 2021, pritej të trajnoheshin 40 zyrtarë të ATK-së, në përputhje me praktikat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me përfitimet për OSHC-të. Nga të dhënat e siguruar gjatë procesit të vlerësimit të Strategjisë, vërehet se ky rezultat nuk është arritur. Ndonëse ka pasur dilema nëse ky tregues është i ndërlidhur me treguesin paraprak që ka të bëjë me rishikimin e kornizës ligjore, e cila do i paraprinte trajnimeve, trajnimi i zyrtarëve tatimor do të mund të bëhej edhe nën kornizën ligjore ekzistuese, dhe kjo do të avanconte më tej zbatimin e kornizës ligjore ekzistuese. **Treguesi 3 “% e rritjes së filantropisë individuale dhe të korporatave në baza vjetore”**. Strategjia synonte të kishte efekte pozitive në rritjen e filantropisë individuale dhe të korporatave në 25% në vitin 2021. Ndonëse këto raste mund dhe do duhej të jenë të regjistruara në ATK, mungojnë të dhëna statistikore të qasshme për ekipin vlerësues për të vlerësuar këtë tregues.⁵¹

Objektivi specifik 3 “Rregullimi i ndarjes së pronës publike për shfrytëzim nga OSHC-të”. Gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë është krijuar baza ligjore për dhënien në shfrytëzim të pronave publike komunale për OSHC-të. Ligji Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i miratuar në vitin 2019, në nenin 7, Paragrafi 3, ka paraparë që “3. Komunitat mund të japin në shfrytëzim pronat e paluajtshme të komunës në periudhën afatshkurtër organizatave të shoqërisë civile me qëllim të përmbushjes së interesit të përgjithshëm.” Po aty është përcaktuar që procedurat e dhënies në shfrytëzim përcaktohen me akt nënligjor i cili miratohet nga Qeveria.⁵² Ndërsa, në vitin 2020, është nxjerrë Rregullorja (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës⁵³, e cila në nenin 16, ka krijuar mundësinë e dhënies në shfrytëzim të përkohshëm të pronave të paluajtshme të komunave, për OSHC-të që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e komunës, me qëllim të përmbushjes së interesit të përgjithshëm, dhe mbi bazën e kriterëve që vendosen me një akt të brendshëm të komunës.⁵⁴ Kjo ka përfshirë edhe lëshimin e qarkoreve informuese për komunitat lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronave publike komunale për OSHC-të.⁵⁵ Prandaj, sa i përket treguesit të parë në kuadër të kësaj objektivë specifike “pronat shtetërore të dhëna në shfrytëzim të OSHC-ve në bazë të standardeve, kriterëve dhe procedurave transparente” sa i përket krijimit të bazës ligjore, mund të vlerësohet se ky tregues është arritur deri në vitin 2021, dhe mund të zbatohet në praktikë. Edhe sa i përket treguesit të dytë që ka të bëjë me trajnimin e shërbyesve civil komunal lidhur me kriteret dhe procedurat për dhënien e pronës publike në shfrytëzim të OSHC-ve përmes raporteve vjetore të monitorimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile është raportuar se ka pasur rezultate. Megjithatë, nuk janë siguruar të dhëna për numrin e saktë të zyrtarëve të trajnuar gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë. Sa i përket treguesit të tretë që ka të bëjë me krijimin e një Regjistri Elektronik të pronave publike që janë dhënë në përdorim të OSHC-ve, nuk është raportuar ndonjë rezultat i arritur.⁵⁶ Megjithatë, gjatë muajit qershor 2023, MAPL ka konfirmuar se do ta përfshijë krijimin e Regjistrit elektronik të pronave shtetërore të dhëna në shfrytëzim për OSHC-të, në platformën e-komunitat, përmes fazës së dytë të zhvillimit dhe

51 Zyra për Qeverisje të Mirë në ZKM nuk ka arritur të sigurojë informata për ekipin vlerësues nëse ka pasur ndonjë rritje të filantropisë individuale dhe të korporatave gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë.

52 Neni 7, Par. 4, Ligji Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=30537>

53 Rregullorja (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=30537>

54 Po aty.

55 Raporti për zbatim të Planit të Veprimit për Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit, 2023, f. 43-44.

56 Po aty, f. 44.

funksionalizimit të kësaj platforme. Rregullorja ka përcaktuar që komunat duhet të publikojnë në ueb faqet e tyre regjistrin e pronave të dhëna në shfrytëzim për OSHC-të, kurse në kuadër të planit të aktiviteteve të Strategjisë (2.2.3), është paraparë *Zhvillimi i Regjistrin Elektronik të Pronave të Shtetit të alokuara për përdorim nga OSHC-të*, si një aktivitet nën përgjegjësinë e MAPL, MPB dhe ZKM. Prandaj, edhe nëse komunat janë duke dhënë në shfrytëzim pronat e paluajtshme për OSHC-të, gjë që është konfirmuar në disa nga intervistat me OSHC-të⁵⁷, në mungesë të regjistrin, mungon një transparencë e duhur, dhe pamundësohet publikimi i të dhënave për dhënien e pronave në shfrytëzim. **Rrjedhimisht, realizimi i objektivës specifike të strategjisë mund të vlerësohet se është arritur vetëm pjesërisht.**

Objektivi specifik 4 “Krijimi i një sistemi të bashkëfinancimit për projektet e OSHC-ve të financuara nga BE-ja”. Nga të dhënat e sigururara gjatë vlerësimit të Strategjisë, mund të konstatohet se nuk ka pasur ndonjë zhvillim sa i përket arritjes së rezultateve në kuadër të kësaj objektivës specifike. Nga diskutimet me përfaqësues të Shoqërisë Civile, theksohet se ka munguar një vullnet institucional për të zhvilluar sistemin e bashkëfinancimit për projektet e OSHC-ve.⁵⁸ Në kuadër të kësaj objektivës specifike ishin paraparë tre tregues: miratimi i kornizës rregulluese dhe institucionale për bashkëfinancim të projekteve të OSHC-ve të mbështetura nga BE; trajnimi i personelit dhe funksionalizimi i sistemit të bashkëfinancimit dhe të paktën 100 projekte të OSHC-ve të bashkëfinancuara deri në vitin 2021. Sistemi i bashkëfinancimit të OSHC-ve, nga këndvështrimi ligjor do të mund të realizohej edhe duke rishikuar rregulloren MF. Nr. 04/2017 për Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OSHC-ve, e cila si e tillë veçse është iniciuar⁵⁹ të ndryshohet⁶⁰ për të avancuar më tej procesin e financimit publik të OSHC-ve. Sidoqoftë, nuk ka pasur ndonjë rezultat të raportuar sa i përket ndryshimeve deri në fazën e përgatitjes së këtij raporti.

Përmbledhje e zbatimit të aktiviteteve

Nëse analizohen aktivitetet e parapara me planin e veprimit, në kuadër të Objektivit Strategjik vërejmë se më së shumti ka pasur progres në kuadër të aktiviteteve që ndërlidhen me financimin publik të OSHC-ve, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe krijimin e një procesi më transparent të financimit publik të OSHC-ve. Gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë vërehet një përmirësim gradual i zbatimit MF. Nr. 04/2017 për Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OSHC-ve, dhe ky përmirësim mund t’i atribuohet edhe rezultateve të aktiviteteve të realizuara në kuadër të Strategjisë dhe planit të veprimit. Megjithatë, është evidente se një numër i madh i aktiviteteve ka mbetur i pa zbatuar. Nuk ka pasur ndonjë zhvillim thelbësor të ndërlidhur me aktivitetet që kanë të bëjnë me krijimin e një ambienti më të favorshëm për zhvillimin e filantropisë, dhe aktivitetet që ndërlidhen me bashkëfinancimin e projekteve të OSHC-ve, duke përfshirë edhe krijimin e bazës së nevojshme ligjore për këtë qëllim. Sa i përket zbatimit të aktiviteteve, raportet vjetore të përgatitura nga Zyra për Qeverisje të Mirë në ZKM, si dhe raportet e monitorimit të përgatitura nga Platforma Civikos, ofrojnë një pasqyrë të zbatimit të aktiviteteve të Strategjisë për këtë objektivë, si në figurën 9 vijim.

57 Intervistë me Dorina LLuka, YMCA, 10.10.2023.

58 Intervista me: Dren Puka; Avdyll Gashi; Vlorian Molliqaj.

59 RREGULLORE MF - NR - 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14831>

60 European Commission, Kosovo 2023 Report, f.11. I qasshëm në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SËD_2023_692%20Kosovo%202023%20report.pdf



Figura 9. Niveli i zbatimit të aktiviteteve në kuadër të objektivës së dytë të Strategjisë

Burimi: ZKM Raportet Vjetore; Platforma Civikos, Raport i Monitorimit të implementimit të Strategjisë 2022

Vlerësimi i efikasitetit

Një nga sfidat në vlerësimin e efikasitetit të zbatimit të Strategjisë në përgjithësi, por edhe sa i përket kësaj objektivë strategjike, është se gjatë procesit të planifikimit të buxhetit qeveritar ka munguar ndërlidhja e planifikimit dhe alokimit të buxhetit sipas aktiviteteve dhe kostos e cila është përfshirë në plan të zbatimit.⁶¹ Për këtë arsye, për disa nga objektivat specifike ka munguar mbulueshmëria buxhetore për aktivitetet e kostuara të Strategjisë. P.sh. ndonëse kanë ekzistuar indikatorë që kanë paraparë bashkëfinancimin e projekteve të OJQ-ve dhe ndihmës së BE-së, nuk ka pasur ndonjë buxhetim për bashkëfinancim gjatë kësaj periudhe të implementimit të Strategjisë. Në anën tjetër, është vërejtur se kostimi i aktiviteteve të Strategjisë duhej të ishte më përmbajtësor, real dhe më i qartë. Megjithatë, jo çdo herë buxhetimi ka qenë shkaktar i mosrealizimit të rezultateve të parapara në kuadër të Strategjisë, për shkak se disa prej objektivave nuk kanë kërkuar buxhet shtesë përveç atij operativ, duke pasur parasysh se të njëjtat do të mund të realizoheshin në kuadër të fushëveprimit të institucioneve. Këtu në veçanti duhet potencuar rezultatet e synuara që kanë të bëjnë me hartimin dhe rishikimin e kornizës ligjore sikurse: Rasti i krijimit të një kornize ligjore për bashkëfinancimin e projekteve të OSHC-ve; Rishikimi i kornizës ligjore për Filantropinë etj. Megjithatë, në të dyja këto raste, ndikimi financiar dhe buxhetor i Strategjisë do shkonte përtej aktiviteteve që janë paraparë aty, p.sh. në buxhet shtesë për bashkëfinancim të projekteve të OSHC-ve dhe efekte në të hyrat tatimore nëse do të kishte ndonjë ndërhyrje në sistemin tatimor si rezultat i rregullave që kanë të bëjnë me filantropinë. Përfundimisht, kjo kosto e Strategjisë nuk ka qenë e analizuar sa duhet dhe nuk ka qenë e planifikuar.

Një numër i aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve për nëpunës civilë, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e Platformës Elektronike të Financimit Publik të OSHC-ve, aktivitete promovuese e të tjera janë mbështetur nga Projekti i KE “Support to the implementation of the Government Strategy for Cooperation with Civil Society” (Mbështetje në zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile) i cili ka përfunduar në vitin 2020. Projekti kishte luajtur një rol kyç në mbështetjen e ZKM-së dhe Ministrisë së Financave në ndërtimin e gjithë sistemit të financimit publik të OSHC-ve, duke përfshirë edhe asistencën teknike në hartimin e bazës ligjore dhe dokumentacionit përcjellës. Një pjesë e aktiviteteve, në veçanti avancimi i Platformës për Financimin Publik të OSHC-ve, është vazhduar përmes projektit TACSO i cili tashmë është në zhvillim

61 Intervistë me z. Habit Hajredini, Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit.

e sipër dhe i cili në masë të madhe do të plotësojë nevojat e mbështjes teknike në vitet në vijim.

Një nga sfidat në vlerësimin e efikasitetit të zbatimit të Strategjisë është mungesa e lidhjes ndërmjet planifikimit dhe alokimit të buxhetit qeveritar gjatë procesit të planifikimit të buxhetit, veçanërisht në lidhje me aktivitetet dhe kostot e përfshira në planin e zbatimit. Kjo ka sjellë mungesë mbulueshmërie buxhetore për disa nga objektivat specifike të Strategjisë, veçanërisht në fushën e konsultimeve dhe të tjera. Megjithatë, informata specifike për shumtë buxhetore të alokuara dhe shpenzuara për aktivitetet që lidhen me zbatimin e Strategjisë, si dhe nëse ato janë shpenzuar në mënyrë efektive nuk ishin në dispozicion për ekipin e vlerësimit të Strategjisë për shkak se në shumicën e rasteve ato nuk kanë qenë të ndara nga buxheti tjetër i institucionit. Në këtë drejtim, është e rekomandueshme që raportet vjetore të zbatimit të Strategjisë të ofrojnë informata më të sakta sa i përket zbatimit, duke përfshirë edhe aspektet buxhetore.

Vlerësimi i relevancës

Gjatë vlerësimit të Strategjisë, përmes analizimit të dokumenteve, përmes diskutimit me akterët qeveritarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, duke përfshirë edhe anëtarët e Këshillit për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile është potencuar se objektiva strategjike “Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OSHC-ve me interes publik” ka pasur relevancë dhe vazhdon të mbetet relevante edhe për ciklin e ardhshëm të planifikimit strategjik që mbulon këtë fushë. Të gjitha objektivat specifike në kuadër të kësaj objektivave janë vlerësuar relevante, duke pasur parasysh rëndësinë e tyre për të krijuar një mjedis të zhvillimit të qëndrueshëm për OSHC-të. Të njëjtin vlerësim sa i përket relevancës kanë shprehur edhe akterët qeveritarë dhe ata nga shoqëria civile. Në kuadër të kësaj objektivave strategjike është arritur progres i theksuar në pjesën që ka të bëjë me procedurat e financimit publik të OSHC-ve, duke përfshirë rritjen e transparencës dhe llogaridhënies sa i përket financimit publik të OSHC-ve, përmes hapjes së thirrjeve publike, publikimit të raporteve më të plota të financimit të projekteve të OSHC-ve, përfshirë edhe avancimin e platformës elektronike. Pavarësisht kësaj, objektiva si tërësi mbetet relevante për shkak të nevojës për të vazhduar me përmbushjen dhe avancimin e përmbushjes së kriterëve të financimit publik të OSHC-ve, ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve të institucioneve, avancimit të bazës ligjore që mbulon fushën e filantropisë, dhe krijimit të një sistemi të bashkëfinancimit të projekteve të OSHC-ve.

Vlerësohet se niveli i instrumenteve për matjen e progresit, si treguesit apo targetet, kanë nevojë që të kenë mbulueshmëri më të mirë të fushëveprimit të objektivave, si dhe përveç matjes kuantitative të sigurojnë edhe mundësinë për matje kualitative të arritjes së objektivave. Në disa nga rastet, treguesit, por edhe synimet (targetet) e vendosura kanë qenë ambicioze, dhe nuk janë ndërtuar mbi bazën e një vlerësimi të duhur.

Vlerësimi i Ndikimit

Miratimi i Rregullores MF. Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve⁶² ka pasur një ndikim të rëndësishëm në mënyrën e ofrimit të mbështetjes financiare publike për OSHC-të. Rrjedhimisht është rritur transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve publike me rastin e ofrimit të mbështetjes publike për OSHC-të dhe është rritur konkurrueshmëria mes vet OSHC-ve sa u përket projekteve të zbatuara përmes fondeve publike.⁶³ Gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë, vërehet përmirësim i vazhdueshëm sa i përket zbatimit të thirrjeve publike për financimin e projekteve të OSHC-ve. Përveç përmirësimit të sistemit të zbatimit të kriterëve të thirrjeve publike, edhe procesi i raportimit për mbështetjen financiare publike për OSHC-të është avancuar, duke ndikuar në rritje të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike.

62 RREGULLORE MF - NR - 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE , shih në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=14831>

63 Intervistë me: Dren Puka; Vlorian Molliqaj; Avdyl Gashi; Trendinë Dreshaj; Dardan Kryeziu.

Edhe pse ende ekzistojnë sfida, kryesisht për shkak të mungesës së burimeve njerzore si dhe sfidat që ndërlidhen me ngritjen dhe mbajtjen e kapaciteteve të burimeve njerzore, Strategjia ka pasur ndikim pozitiv sa i përket avancimit të sistemit të financimit publik të OSHC-ve, të bazuar në rregulloren MF. Nr. 04/2017.⁶⁴ Ndikimi i Strategjisë mund të vlerësohet pozitiv edhe sa i përket krijimit të rregullave ligjore për dhënien në shfrytëzim të pronave publike komunale për OSHC-të.⁶⁵

Sa u përket indikatorëve specifik, që ndërlidhen me kornizën ligjore që mbulon fushën e filantropisë, si dhe krijimin e një sistemi të bashkëfinancimit për projektet e OSHC-ve, Strategjia nuk ka arritur të ketë ndikimin e parashikuar. Kjo ka bërë që të mos ketë një sistem të qëndrueshëm dhe të diversifikuar të financimit të OSHC-ve. Kanë ndikuar shumë faktorë, duke përfshirë COVID 19 dhe mungesën e një vullneti të mirëfilltë për të qar përpara zbatimin e Strategjisë në këto fusha.⁶⁶ Kjo mund të konfirmohet edhe me mos realizimin e aktiviteteve të parapara me planin e veprimit për realizimin e Strategjisë.

Vlerësimi i Qëndrueshmërisë

Që nga viti 2017, Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrisë së Financave, kanë qenë të përkushtuara në krijimin e një sistemi transparent të financimit publik të OSHC-ve. Krijimi i rregullave për një financim transparent, ofrimi i trajnimeve për nivelin qendror dhe lokal, krijimi i një platforme që mundëson raportimin online dhe ofrimi i këshillave të vazhdueshme nga ana e ZQM-së dhe Ministrisë së Financave për të gjitha institucionet publike gjatë zbatimit të rregullores MF. Nr. 04/2017, tregon për qëndrueshmërinë dhe avancimin e vazhdueshëm të sistemit. Nga raportet e Adutimit të Pasqyrave Financiare të Organizatave Buxhetore, të publikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit, gjatë viteve të fundit vërehet se ka një numër më të vogël të gjetjeve, e që tregon edhe për rritjen graduale të kapaciteteve të institucioneve publike në zbatimin e thirrjeve publike për financimin e projekteve të OSHC-ve. Prandaj, sa i përket financimit publik të OSHC-ve, mund të konkludohet se sistemi si i tillë është krijuar, funksionon dhe është i qëndrueshëm. Edhe aspektet që kanë të bëjnë me rregullimin e kriterëve ligjore për dhënien në shfrytëzim të pronës publike komunale, janë vendosur, ka pasur disa trajnime dhe ka iniciativa për krijimin e një regjistri publik. Megjithatë, në këtë fazë është herët të vlerësohet qëndrueshmëria e sistemit përderisa i njëjti nuk ka filluar të zbatohet në praktikë.

Megjithatë, qëndrueshmëria e gjithë sistemit në kuptimin e kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OSHC-ve me interes publik, do të jetë jo e plotë pa arritjen e rezultateve sa i përket të gjithë treguesve që kanë qenë pjesë e kësaj objektivë strategjike, në veçanti krijimi i sistemit të bashkëfinancimit, dhe rishikimi i kornizës ligjore që rregullon aspekte të ndërlidhura me filantropinë.

Tabela e vlerësimit të treguesve

Vlerësimi i zbatimit të objektivit të dytë strategjik bëhet përmes treguesve dhe synimeve të përcaktuar në Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 dhe planit të zbatimit të saj. Rezultatet e arritura sa i përket objektivës strategjike në vlerësim janë paraqitur si në vijim.

Tabela 2: Statusi i arritjes së synimeve për objektivin e dytë strategjik "Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OSHC-ve me interes publik"

64 European Commission, Kosovo 2023 Report, f.11, i qasshëm në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SËD_2023_692%20Kosovo%202023%20Report.pdf

65 Gjatë krijimit të bazës ligjore, OSHC-të janë konsultuar nga MAPL, dhe janë marrë për bazë komentet dhe sugjerimet e tyre. E konfirmuar edhe nga intervistat e realizuara me përfaqësues të shoqërisë civile. Intervisë me Dren Puka, KCSF.

66 Intervistë me: Dren Puka; Vlorian Molliqaj, Avdyl Gashi; Trendelinë Dreshaj; Dardan Kryeziu.

Objektivi Strategjik 2: Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OSHC-ve me interes publik

Treguesi	Vlera bazë	Objektivi i përkohshëm [2019]	Synimi final 2021	Rezultati i Synuar	Synimi i arritur
Përqindja e institucioneve që kryejnë thirrje publike për financimin e OSHC-ve në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OSHC-ve	50%	75%	100%	Thirrjet publike në përputhje të plotë me Rregulloren mbi kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OSHC-ve.	Pjesërisht i arritur: <ul style="list-style-type: none"> - Në përgjithësi hapen thirrje publike, por kualiteti i thirrjeve dhe i gjithë procesit nuk është në linjë të plotë me rregulloren; - Mungojnë kapacitete institucionale për të zbatuar thirrjet publike në përputhje me kriteret e rregullores;
Objektivi specifik 2.1: Fuqizimi i kapaciteteve të Ministrive dhe Komunave për zbatimin e standardeve për financimin publik të OSHC-ve					
Numri i shërbyesve civil të trajnuar për kriteret, standardet dhe procedurat, e financimit publik të OSHC-ve	70 shërbyes civil të trajnuar		300 shërbyes civil të trajnuar		<ul style="list-style-type: none"> - Pjesërisht i arritur; - Mungojnë të dhëna për numrin e saktë të shërbyesve civil të trajnuar;
Objektivi specifik 2.2: Përmirësimi i kornizës ligjore dhe institucionale për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave					
Aktet e nevojshme ligjore për rregullimin e filantropisë individuale dhe të korporatave të ndryshuara ose të miratuara	0		100%		- Nuk është arritur
Numri i zyrtarëve të tatimit të trajnuar në praktikën për administrimin e përfitimeve në tatime për filantropi	0		40		- Nuk është arritur
% e rritjes së filantropisë individuale dhe të korporatave në baza vjetore	0		25%		- Nuk ka informacione

Objektivi specifik 2.3: Rregullimi i ndarjes së pronës publike për shfrytëzim nga OSHC-të					
Pronat shtetërore të dhëna në shfrytëzim të OSHC-ve në bazë të standardeve, kritereve dhe procedurave transparente	0		Zbatuar		- Arritur të paktën në aspektin e rregullativës ligjore
Numri i shërbyesve civil të trajnuar për zbatimin e standardeve, kritereve dhe procedurave për dhënien e pronës publike në shfrytëzim të OSHC-ve	0		30		- Është raportuar për zhvillim të trajnimeve, por mungojnë të dhëna për numrin e të trajnuarve
Regjistri Elektronik i pronave publike që janë dhënë në përdorim të OSHC-ve e zhvilluar dhe funksionale	0		I zhvilluar		- Nuk është arritur
Objektivi specifik 2.4: Krijimi i një sistemi të bashkëfinancimit për projektet e OSHC-ve të financuara nga BE-ja					
Treguesi: Miratimi i Kornizës rregulluese dhe institucionale për bashkëfinancim të projekteve të OSHC-ve të mbështetura nga BE	0		Miratuar		- Nuk është arritur
Treguesi: Numri i personelit përkatës të institucionit përgjegjës që është trajnuar për zbatimin e standardeve dhe procedurave për bashkëfinancimin e projekteve të OSHC-ve të financuara nga BE-ja	0		I zhvilluar		- Nuk është arritur
Treguesi: Rritja e numrit të projekteve të OSHC-ve të financuara nga BE-ja	0		100		- Nuk është arritur

2.3. OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: ZHVILLIMI I PRAKTIKAVE DHE PROCEDURAVE TRANSPARENTE PËR KONTRAKTIMIN E OSHC-VE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Efektiviteti

Ndonëse është filluar të punohet në drejtim të krijimit të procedurave transparente për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike, deri më tani nuk ekzistojnë rezultate të matshme në përmbushjen e treguesve të përfshirë në kuadër të kësaj objektive. CIVIKOS në bashkëpunim me ZQM/ZKM dhe me Ministrinë e Financave në vitin 2022 ka zhvilluar një analizë e cila identifikon çështjet kyçe nga perspektiva e nevojës për rregullim ligjor sa i përket kontraktimit të shërbimeve. Kjo analizë, e titulluar “Dokument i politikave lidhur me kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të”⁶⁷ tregon se ekziston baza ligjore në Ligjin për Prokurimin Publik, për të bërë një rregullim me akt nënligjor të kontraktimit të shërbimeve. Dokumenti potencon po ashtu se, bazuar në praktikën e BE-së, është i mundur trajtimi në mënyrë të veçantë i kontraktimit të shërbimeve me OSHC-të. Kjo analizë vlerëson infrastrukturën ligjore të kontraktimit të shërbimeve me OSHC në Republikën e Kosovës, që mbulon gjithë sektorët dhe ligjet specifike të cilët mundësojnë kontraktim të shërbimeve me OSHC-të, dhe në të njëjtën kohë ofron rekomandime për rregullim me akte nënligjore të fushës së kontraktimit të shërbimeve me OSHC-të, duke propozuar një strukturë bazë të aktit nënligjor që do duhej të burojë nga Ligji i Prokurimit Publik.⁶⁸

Duke pasur parasysh që të gjitha objektivat specifike në kuadër të kësaj objektive strategjike janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, mungesa e rezultateve në krijimin e mekanizmave ligjore për kontraktimin e shërbimeve ka pamundësuar që të arrihen rezultate në kuadër të objektivave specifike.

Në kohën e kryerjes së këtij vlerësimi, ekipi vlerësues është informuar se Ministria për Financa është në proces të themelimit të grupit punues për hartim të legjislacionit sekondar që rrjedhë nga ligji për Prokurim Publik, dhe ka kërkuar edhe nga Këshilli për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile të përzgjedhë anëtarët nga shoqëria civile për të qenë pjesë e grupit punues.⁶⁹

Përmbledhje e zbatimit të aktiviteteve

Siç mund të shihet nga figura 10, në kuadër të kësaj objektive nuk ka aktivitete të zbatuara në tërësi. Rrjedhimisht, vetëm 33% e aktiviteteve janë në fazat e hershme të fillimit të zbatimit të tyre.

67 Platforma CIVIKOS, Dokument i politikave lidhur me kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të, 2022. I qasshëm në: <https://civikos.net/wp-content/uploads/2023/12/DOKUMENT-I-POLITIKAVE-LIDHUR-ME-KONTRAKTIMIN-E-SHERBIMEVE-NGA-OSHC-te.pdf>

68 Po aty.

69 Intervistë me z. Dardan Kryeziu, Platforma CIVIKOS, Prishtinë, tetor 2023.




Figura 10. Niveli i zbatimit të aktiviteteve në kuadër të objektivës së tretë të Strategjisë

Burimi: ZKM Raportet Vjetore; Platforma Civikos, Raport Monitorimi 2022, i Zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023

Efikasiteti

Si institucionet qeveritare ashtu edhe OSHC-të kanë konfirmuar se gjatë periudhës që mbulon Strategjia, burimet financiare për fushën që rregullon kontraktimin e shërbimeve në nivelin qendror të qeverisjes, ishin të pamjaftueshme. Megjithatë, duhet potencuar, se arritja e rezultateve në kuadër të shumë prej objektivave specifike në këtë fazë ka qenë e ndërlidhur me krijim të një kornize ligjore, për të cilën nuk mund të thuhet se nuk kanë ekzistuar kapacitete institucionale të vet institucioneve apo mbështetje të donatorëve dhe vet shoqërisë civile.

Relevanca

Objektiva strategjike si e tillë dhe gjithë objektivat specifike kanë qenë dhe mbeten relevante. Organizatat e Shoqërisë Civile ofrojnë shërbime në fushën sociale dhe familjare, shëndetësore, arsimore, kulturore, por edhe në fushat tjera.⁷⁰ Përveç kësaj, ekziston bazë ligjore në legjislacionin shëndetësor, arsimor, atë të shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe legjislacionin për ndërmarrjet sociale, që institucionet publike të kontraktajnë shërbime nga OSHC-të. Sidoqoftë, mungesa e procedurave të detajuara të kontraktimit të shërbimeve, por edhe definimi i aktiviteteve ekonomike të OSHC-ve sipas legjislacionit tatarimor, kanë krijuar vështirësi në kontraktimin e shërbimeve të cilat në shumë raste kanë qenë të nevojshme për t'u kontraktuar nga perspektiva e institucioneve publike. Prandaj, objektivi strategjik, por edhe ato specifike, mbeten relevante për t'u adresuar në procesin e ardhshëm të planifikimit strategjik. Relevanca dhe nevoja për adresim konfirmohet edhe nga sektori publik⁷¹ por edhe nga shoqëria civile.⁷² Në të njëjtën kohë, janë dhënë rekomandime edhe nga grupi tematik për këtë objektivë, i krijuar në nivel të Këshillit për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile, të cilat si të tilla është mirë të adresohen në periudhën e ardhshme të planifikimit strategjik.

Ndikimi dhe qëndrueshmëria

Meqenëse nuk ka pasur aktivitete përmbajtësore që do të ndikonin në realizimin e synimeve të Strategjisë në kuadër të këtij objektivi, edhe ndikimi i Strategjisë në këtë fushë është pothuajse i pamatshëm. Megjithatë, gjatë vitit 2023 kanë filluar disa iniciativa në kontekstin e krijimit të

70 <https://www.facebook.com/photo/?fbid=3766190800165042&set=pcb.3766194436831345>

71 Intervistë me Enis Spahiu, zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, 09.10.2023.

72 Intervista të realizuara me Vlorian Molliqaj, Dren Puka; Agmie Osmani; Dardan Kryeziu; Avdyl Gashi.

bazës ligjore për kontraktimin e shërbimeve të OSHC-ve, e cila pritet të ketë ndikime pozitive në të ardhmen. Nga ana tjetër, në disa fusha janë krijuar kapacitete të Organizatave të Shoqërisë Civile për ofrim të shërbimeve, qoftë përmes mbështetjes së donatorëve apo subvencioneve të ofruara nga institucionet publike. Prandaj, krijimi i një mekanizmi ligjor për kontraktimin e këtyre OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve publike do të mundësonte të sigurohet qëndrueshmëria dhe avancimi i tyre, e në të njëjtën kohë do të mundësonte që përfituesit të marrin shërbime profesionale.

Tabela e treguesve

Tablela 3: Statusi i arritjes së synimeve për objektivin e tretë strategjik “Zhvillimi i praktikave dhe procedurave transparente për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike”

Objektivi strategjik 3: Zhvillimi i praktikave dhe procedurave transparente për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike			
Treguesi	Vlera bazë	Synimi final 2021	Synimi i arritur
Numri i OSHC-ve të kontraktuara për ofrimin e shërbimeve publike përmes thirrjeve publike tenderëve	Numri i OSHC-ve të kontraktuara	20%	Nuk është arritur
Objektivi specifik 3.1: Përmirësimi i kornizës së përgjithshme ligjore dhe institucionale për rregullimin e aktiviteteve ekonomike të OSHC-ve			
Standardet dhe procedurat ligjore për aktivitetet ekonomike të OSHC-ve janë qartësuar	0	Legjislacioni mbi tatimin e korporatave për aktiviteteve ekonomike të OSHC-ve i përcaktuar (Përveç OSHC-ve me status të përfituesit publik); Udhëzimet për administratën tatimore për trajnimin e aktiviteteve të OSHC-ve janë zhvilluar	Nuk është arritur
Numri i personelit përkatës të Administratës tatimore që është trajnuar për përdorimin e standardeve dhe procedurave për rregullimin e aktiviteteve ekonomike të OSHC-ve	0	30	Nuk është arritur
Përqindja e OSHC-ve që kanë përfituar nga përjashtimet tatimore dhe përfitimet e tjera fiskale	0	50%	Nuk është arritur
Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i njohurive të institucioneve rreth mundësive (modeleve) ekzistuese për kontraktimin e OSHC-ve			
Treguesi: Numri i institucioneve qendrore dhe lokale është plotësuar dhe nevojitet vlerësimi për të identifikuar fushat ku OSHC-të mund të ofrojnë shërbime publike	3	14	Nuk është arritur

Treguesi: Numri i shërbyesve civil të trajnuar në fushën e kontraktimit të OSHC-ve në lidhje me modelet e ndryshme për ofrimin e shërbimeve publike	10	30	Nuk është arritur
Treguesi: Numri i Ministrive dhe komunave të cilat kanë kontraktuar OSHC për të ofruar shërbime publike	5	20	Nuk është arritur
Objektivi specifik 3.3: Mbledhje dhe publikim sistematik i informatave mbi potencialin e OshC-ve për të ofruar shërbime publike për institucionet publike			
Treguesi: Përqindja e mbledhjes së të dhënave të plotësuar me informacionin për OSHC-të të cilat mund të ofrojnë shërbime publike	0	20%	Nuk është arritur
Objektivi specifik 3.4: Përmirësimi i legjislacionit që rregullon standardet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të			
Treguesi: Legjislacioni i cili rregullon standardet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të është ndryshuar	0	Zbatimi i ndryshimeve të nevojshme të ligjeve përkatëse	Nuk është arritur
Treguesi: Personeli përkatës i ministrive dhe komunave e përdorin Doracakun Online me udhëzimet për kontraktimin e OSHC-ve për të ofruar shërbime në bazë të kornizës ligjore të ndryshuar	0	Manuali me udhëzime për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike i përgatitur dhe shpërndarë	Nuk është arritur

2.4. OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: RITJA DHE PROMOVIMI I VULLNETARIZMIT NË PROGRAMET ME INTERES PUBLIK

Në nivel të objektivit strategjik *“Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programet me interes publik”* kishte një tregues, por për vlerësimin e tij nuk kishte informacion. Në nivel të objektivave specifike, nga katër tregues, për dy nuk ka pasur zhvillime, ndërsa për dy tregues nuk ka informata për të bërë vlerësimin (shih tabelën nr. 4).

Vlerësimi i efektivitetit

Ky objektivi strategjik kishte përfshirë tri objektiva specifike, dhe vlerësimi i tyre përfshinte pesë tregues, si dhe synime të tyre. Për shkak të mungesës së zhvillimeve në lidhje me këto objektiva në fushën e vullnetarizmit dhe mungesës së informacionit⁷³, vlerësimi i arritjes së objektivave veç e veç për këtë fushë, sipas metodologjisë së përdorur për objektivat tjera, ishte i pamundur. Bazuar në Planin e Veprimit të Strategjisë, hartimi dhe miratimi i koncept-dokumentit për vullnetarizmin ishte paraparë të bëhej gjatë periudhës 2019-2023. Si rezultat, një version i Koncept-Dokumentit për zhvillimin e vullnetarizmit në Kosovë është përgatitur në vitin 2019. Gjatë vitit 2020 dhe 2021 janë zhvilluar gjithashtu disa aktivitete që lidhen me diskutime me palë të ndryshme në lidhje me koncept-dokumentin për vullnetarizmin. Përfundimi i këtij koncept-dokumenti ishte parashikuar për vitin 2022⁷⁴, por dokumenti ende nuk është finalizuar dhe nuk ka pasur progres në procedurat për miratimin e tij.

Në të njëjtën kohë, shumë nga palët e interesit të cilat janë konsultuar për qëllime të këtij vlerësimi (shih shtojcën 2) konsiderojnë se projekt-koncept dokumenti në versionin aktual duhet të përmirësohet substancialisht. Kjo është bërë për shkak se qasja e politikave për sistemin e vullnetarizmit në kuadër të Qeverisë është ende e hapur për diskutim. Prandaj, aktivitetet e tjera të planifikuara për fushën e vullnetarizmit do të ndërmerren vetëm pasi të vendoset mbi këto politika përmes koncept-dokumentit. Kështu që progresi në realizimin e objektivit që lidhet me vullnetarizmin është penguar edhe më tej. Një aktivitet që mund të ndihmojë në qartësimin e kësaj qasje është edhe përdorimi i rekomandimeve të ofruara nga një iniciativë e ndërmarrë me mbështetjen e KCSF në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar (CEA). Këtu përfshihet studimi fillestar rreth vullnetarizmit në Kosovë. Dokumenti tashmë është në versionin e punës dhe ofron rekomandime dhe zgjidhje konkrete për përmirësimin e ekosistemit të vullnetarizmit në Kosovë.

Përveç kësaj, gjatë kësaj periudhe është ndërtuar dhe funksionalizuar platforma online kosovovolunteers.org. Platforma ka për synim të bashkojë vullnetarët dhe rekrutuesit, ndërsa ofron mjete dhe burime për të ndihmuar zhvillimin e programeve të përfshirjes së komunitetit. Platforma “Vullnetarët e Kosovës,” e zhvilluar me mbështetjen e UNICEF-it, është tashmë në përdorim të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Megjithatë, përditësimi i platformës për të përmbushur zhvillimet dhe nevojat e paraqitura, si dhe kapacitetet e MKRS-së për mirëmbajtjen dhe avancimin e saj, është një sfidë. Në të njëjtën kohë, fushëveprimi i platformës përfshinë vetëm kategorinë e vullnetarëve të moshës së rinisë. Prandaj, kërkohet zgjerimi i saj për të përfshirë edhe kategori tjera të vullnetarëve.

73 P.sh. për treguesin për “Përqindja e qytetarëve të njoftuar për mundësitë dhe vlerat e vullnetarizmit” nuk është zhvilluar ndonjë hulumtim për të vlerësuar se sa janë njoftuar qytetarët për mundësitë dhe vlerat e vullnetarizmit.

74 Raporti i ZQM për zbatimin e strategjisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile Strategjinë 2022.

Përmbledhje e zbatimit të aktiviteteve

Bazuar në të dhënat në dispozicion, nga gjithsej 6 aktivitete të planifikuara, 3 aktivitete janë në proces të zbatimit ndërsa 3 të tjera nuk janë zbatuar fare. Rrjedhimisht, 50 përqind e aktiviteteve janë në proces të zbatimit ndërsa 50 përqind e aktiviteteve nuk janë zbatuar.




Figura 11. Niveli i zbatimit të aktiviteteve në kuadër të objektivës katër të Strategjisë

Burimi: ZKM Raportet Vjetore; Platforma Civikos, Raport Monitorimi për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, CIVIKOS, tetor 2023.

Efikasiteti

Si institucionet qeveritare, ashtu edhe OSHC-të, kanë konfirmuar se gjatë periudhës që mbulon Strategjia, burimet financiare për fushën e vullnetarizmit në nivelin qendror të qeverisjes ishin shumë të kufizuara. Nevoja për ndarje të resurseve financiare dhe njerëzore për vullnetarizimin, me theks të veçantë për programet e vullnetarizmit për rininë, është theksuar edhe nga Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2023.⁷⁵ Por, vlen të përmendet se janë regjistruar aktivitete pozitive në mbështetjen e ofruar nga niveli lokal, ku financime për vullnetarizmin janë ofruar nga 10 komuna⁷⁶.

Relevanca

Konsiderohet se ndërmarrja e masave të duhura për ndërtimin e sistemit që do të mbështesë aktivitetet vullnetare është e rëndësishme dhe relevante. Ambienti për vullnetarizim duhet të përmirësohet, përfshirë zhvillimin e një kornize të përshtatshme legjislative në përputhje me standardet ndërkombëtare.⁷⁷ Shkalla e zbatimit tregon qartë se masat e parapara, megjithëse shumë bazike, janë ose ambicioze ose janë prekur nga faktorë të tjerë që kanë ndikuar në moszbatimin e tyre. Konsiderohet se numri i vullnetarëve të cilët janë të interesuar dhe të angazhuar për të ofruar shërbimet e tyre vullnetare është i lartë, dhe si rezultat kërkohet që të merren masa mbështetëse udhëzuese, financiare dhe të tjera nga institucionet⁷⁸. Prandaj është e nevojshme përshtatja e masave relevante, por edhe identifikimi i treguesve të përshtatshëm. Përveç kësaj, kërkohet evitimi i elementeve të paqarta në këto segmente. Kur themi këtë, mund të përmendim shembullin e treguesit 4.3.1. *Përqindja e qytetarëve të njoftuar për mundësitë dhe vlerat e vullnetarizmit, synimi (targeti) i të cilit është % e qytetarëve që e konfirmojnë qëndrimin pozitiv kundrejt vullnetarizmit*

75 European Commission Report on Kosovo 2023 f. 11. Shih: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SĚD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf

76 Burimi: intervista me Jehona Gjuergjala nga organizata TOKA.

77 European Commission Report on Kosovo 2023 f. 11. Shih: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf

78 Intervistw me Jehona Gjulgjela. OJQ, Toka, Datw 09.10.2023,

dhe përfshirjes në aktivitete vullnetare. Kështu, shihet qartë shpërputhja mes treguesit dhe synimit, d.m.th treguesi synon matjen e përqindjes së qytetarëve të cilët janë njoftuar me mundësitë e vullnetarizmit, ndërsa synimi (targeti) matë përqindjen e qytetarëve që kanë qëndrim pozitiv për vullnetarizmin dhe ativitetet vullnetare. Të jesh i njoftuar, dhe të mbash qëndrim pozitiv për vullnetarizmin ka dallim. Nëse hulumtojmë për shkallën e qytetarëve që kanë qëndrim pozitiv për vullnetarizmin, nuk mund të marrim informatën se sa ka njohuri për mundësitë dhe vlerat e vullnetarizimit, siç kërkon treguesi.

Ndikimi dhe qëndrueshmëria

Meqenëse nuk ka pasur aktivitete përmbajtësore në kuadër të këtij objekti, atëherë edhe ndikimi i Strategjisë në zhvillimin e sektorit të vullnetarizmit është pothuajse i pamatshëm. Nëse flasim për qëndrueshmërinë, aktiviteti i vetëm që mund të përmendet është platforma elektronike e vullnetarizmit. Për të siguruar ndikim dhe qëndrueshmëri të saj, është e rëndësishme të sigurohet kujdesi për mirëmbajtjen, funksionalitetin dhe përditësimin e saj me të dhënat e nevojshme.

Tabela e treguesve

Tabela 4: Statusi i arritjes së synimeve për objektivin e katërt strategjik “Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programet me interes publik”

Objektivit Strategjik 4. Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programet me interes publik				
Treguesi	Vlera bazë	Synimi final (viti 2021)	Arritja 2021	Arritja 2023
Indicator: Numri i vullnetarëve të përfshirë në OShC	n/a	10 % rritje e pjesëmarrjes së vullnetarëve në OShC	Nuk ka informata	Nuk ka informata
Objektivi Specifik 4.1: Krijimi i një kornize gjithëpërfshirëse ligjore dhe institucionale për të ndihmuar në zhvillimin e vullnetarizmit				
Treguesi: Korniza ligjore dhe institucionale gjithëpërfshirëse për mbështetjen e zhvillimit të vullnetarizmit është miratuar	Kuadri ligjor kufizues për rregullimin dhe promovimin e vullnetarizmit	Kuadri ligjor dhe institucional për mbështetjen e zhvillimit të vullnetarizmit plotësisht funksional	Nuk ka pasur zhvillime	Nuk ka pasur zhvillime
Objektivi specifik 4.2: Zhvillimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të rekrutuar, angazhuar dhe menaxhuar vullnetarët				
Treguesi: Skema e granteve e zhvilluar për financimin e aktiviteteve për zhvillimin e kapaciteteve të OSHC-ve për menaxhimin efektiv të vullnetarëve		Disa OShC veprojnë si qendra burimore vullnetare për të ofruar trajnime për menaxhimin efektiv të vullnetarizmit	Nuk ka pasur zhvillime	Nuk ka pasur zhvillime
Treguesi: Zhvillimi i një Manuali me udhëzime për angazhimin dhe menaxhimin e vullnetarëve		Manuali me udhëzime për angazhimin e vullnetarëve i përgatitur dhe shpërndarë, bazuar në kornizën ligjore të ndryshuar	Nuk ka pasur zhvillime	Nuk ka pasur zhvillime

Objekti specifik 4.3: Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për mundësitë dhe vlerat e vullnetarizmit

Treguesi: Përqindja e qytetarëve të njoftuar për mundësitë dhe vlerat e vullnetarizmit		% e qytetarëve që e konfirmojnë qëndrimin pozitiv kundrejt vullnetarizmit dhe përfshirjes në aktivitete vullnetare	Nuk ka informata	Nuk ka informata
---	--	--	------------------	------------------

3. MEKANIZMAT INSTITUCIONAL PËR MBIKQYRJEN E ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Këshilli për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile paraqet një nga strukturat kryesore të përbashkëta zyrtare mes Organizatave të Shoqërisë Civile dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. Këshilli është themeluar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës⁷⁹ dhe funksionon si mekanizmi këshillues për koordinimin e proceseve të bashkëpunimit midis qeverisë dhe shoqërisë civile. Këshilli përbëhet nga 29 anëtarë, prej të cilëve 15 janë përfaqësues nga shoqëria civile dhe 14 janë përfaqësues nga institucionet e Republikës së Kosovës. Ky mekanizëm drejtohet bashkërisht nga Sekretari i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit dhe Drejtori Ekzekutiv i Platformës CIVIKOS. Gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë, 2019 – 2023, Këshilli ka mbajtur gjithsej 11 takime.⁸⁰ Këshilli ka miratuar rregullat e tij të punës.⁸¹

Qëllimi kryesor i Këshillit është rritja e bashkëpunimit midis Qeverisë dhe shoqërisë civile, promovimi, dhe mbështetja e shoqërisë civile, si dhe të sigurojë koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile. Për këtë qëllim, në kuadër të Këshillit janë krijuar katër ekipe të punës për secilin objektivi të Strategjisë, të cilat udhëhiqen bashkërisht nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare, ndërsa, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit është institucioni përgjegjës për koordinimin e punës së Këshillit dhe shërben si sekretariat i këtij Këshilli. Krahas ekipeve të punës Platforma CIVIKOS me mbështetje të Programit për Angazhim Qytetar (i cili zbatohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në Kosovë) ka krijuar edhe katër grupe tematike sipas objektivave të Strategjisë në përbërje të të cilave janë përfshirë përfaqësues/aktivistë të shoqërisë civile. Roli i këtyre grupeve tematike është që të identifikojnë sfidat kryesore në procesin e zbatimit të Strategjisë.⁸² Grupet tematike janë themeluar në mars të vitit 2022, ndërsa kanë përgatitur një listë të rekomandimeve për adresimin e sfidave/problemeve të shoqërisë civile në strategjinë e re, që kryesisht bazohen në sfidat gjatë zbatimit të strategjisë ekzistuese.

Vlerësuar nga mandati i përcaktuar me vendimin e Qeverisë për themelimin e tij, Këshilli ka mandat të rëndësishëm në funksion të mbikqyrjes së zbatimit të Strategjisë. Shumica e të intervistuarve në procesin e këtij vlerësimi kanë dhënë mendimin e tyre se Këshilli ka pasur sfida në funksionimin e tij, dhe rrjedhimisht kjo ka ndikuar në zvogëlimin e ndikimit të tij në avancimin e objektivave të Strategjisë. Ndër shkaqet kryesore që kanë ndikuar në punën e Këshillit, janë evidentuar si në vijim: Këshilli nuk ka arritur të jetë efektiv për të shtyrë përpara zbatimin e Strategjisë, dhe thjesht është shndërruar në një mekanizëm ku raportohet për zbatimin e objektivave të Strategjisë, dhe roli i tij ka mbetur këtu. Disa nga shkaqet kryesore kanë të bëjnë me ndërrimin e shpeshtë të përfaqësuesve të Qeverisë në Këshill dhe në takimet e rregullta të Këshillit dhe procesi i përzgjedhjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile në Këshill, siç është elaboruar në vijim.

79 Vendimi Nr.05/96 i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Themelimin e Këshillit për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile, datë 02.04.2019. Shih: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/11/Vendimi-per-themelimin-e-Keshillit.pdf>

80 RAPORT I MONITORIMIT ZBATIMI I STRATEGJISË QEVERTARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2019-2023, Këndvështrim i Sekretariatit të Platforma Civikos, Prishtinë, Tetor 2023, Faqe 26. I qasshëm në: https://civikos.net/wp-content/uploads/2023/10/Raporti-3_compressed.pdf

81 Rregullat e Punës së Këshillit për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile, shih: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/11/Rregullat-e-Punes-se-Keshillit-per-Bashkëpunim-te-Qeverise-me-Shoqerine-Civile.pdf>

82 RAPORT I MONITORIMIT ZBATIMI I STRATEGJISË QEVERTARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2019-2023, Këndvështrim i Sekretariatit të Platforma Civikos, Prishtinë, Tetor 2023, Faqe 26. I qasshëm në: https://civikos.net/wp-content/uploads/2023/10/Raporti-3_compressed.pdf

Ndërrim i shpeshtë/zëvendësim i anëtarëve që përfaqësojnë Qeverinë, rrjedhimisht, mungesë e memories institucionale për çështjet e diskutuara dhe dakorduara. Prandaj, një qasje e tillë e delegimit të përgjegjësive te një nivel më i ulët i zyrtarëve, madje edhe për të marrë pjesë në mbledhjet e rregullta të Këshillit është vlerësuar si joserioze në kontekstin e zbatimit të Strategjisë dhe bashkëpunimit të Qeverisë me shoqërinë civile.

- Procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit nga shoqëria civile, ndonëse i dizajnuar mirë si koncept, nuk ka rezultuar çdoherë me përfaqësimin më të mirë të interesave të shoqërisë civile në Këshill dhe në raport me Qeverinë. Përfaqësuesit e shoqërisë civile të intervistuar gjatë vlerësimit, kanë potencuar se disa nga përfaqësuesit e Shoqërisë Civile në Këshill më shumë e kanë konsideruar pjesëmarrjen në Këshill si një lloj privilegji se sa përfaqësim të interesave të shoqërisë civile dhe për ti shtyrë përpara proceset që ndërlidhen me krijimin e një mjedisi më të favorshëm për shoqërinë civile. Kjo ka bërë që të mungojë edhe presioni i shoqërisë civile, për shkak se ka ekzistuar një lloj shikëputje në mes të anëtarëve të shoqërisë civile të përzgjedhur në këshill dhe vetë shoqërisë civile që i ka përzgjedhur ata.

Sa u përket mekanizmave institucionale, Zyra për Qeverisje të Mirë në ZKM ka luajtur rol kyç në proceset e zbatimit të strategjisë dhe në bashkëpunimin me shoqërinë civile në përgjithësi. Megjithatë, fushëveprimi i ZQM-së është shumë i gjerë, dhe nuk mbulon vetëm fushat e strategjisë, rrjedhimisht, me kapacitetet njerëzore që ZQM ka aktualisht është sfiduese të mbulohen në mënyrë të duhur të gjitha fushat e përgjegjësive së saj.

4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në përgjithësi shkalla e zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 varion nga fusha në fushë. Përderisa në fushën e konsultimeve publike dhe financimit të OSHC-ve përqendrimi në zbatim ka qenë më i theksuar, zbatimi në fushën e kontraktimit të shërbimeve nga OSHC-të si dhe vullnetarizmit mbesin shumë prapa.

Strategjia ka arritur sukses në përfshirjen e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) në grupe punuese dhe në ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe mentorimeve. Avancimi i platformës me qasje nga personat me aftësi të kufizuara dhe zgjerimi i komponentës së sistemit të konsultimit janë pozitive. Megjithatë, sfidat në fushën e konsultimeve tregojnë nevojën për një fokus më të theksuar në cilësi dhe përfshirje të plotë dhe të hershme të palëve të interesuara. Rekomandohet përmirësimi i përdorueshmërisë së platformës dhe përfshirja e akteve të mëtejshme për të rritur diversitetin dhe cilësinë e kontributeve. Rrjedhimisht në procesin e ardhshëm të planifikimit strategjik, rekomandohet të adresohen këto sfida.

Rekomandohet që të definohet më mirë baza ligjore dhe institucionet të ndryshojnë qasjen e tyre, për të mundësuar përfshirje të hershme në proces të konsultimit. Meqenëse angazhimi në proces të konsultimit nga palët e interesuara e sidomos OSHC-të kërkon burime të mjaftueshme dhe ekspertizë, duhet të ketë një planifikim më të mirë dhe informim në kohë të arsyeshme të palëve të interesuara para se procesi i konsultimeve të fillojë. Rekomandohet të rriten kapacitetet në nivel qendror të Qeverisë dhe ministrive si dhe përqendrimin në monitorim të procesit të konsultimit, nga aspekti i plotësisë së standardeve nga aspekti kualitativ.

Në kuadër të mundësisë së avancimit të fushëveprimit dhe kornizës strategjike për ciklin e ardhshëm planifikues, rekomandohet që udhëzimet e ofruara nga Drejtoria e Zgjerimit përmes “Udhëzuesi për Mbeshtetje të BE për Shoqërinë Civile në Rajonin e Zgjerimit 2021-2027”⁸³ dhe Parimet e OECD/SIGMA për Administratën Publike⁸⁴ të shërbejnë si referencë për vendosjen e kornizës së ardhshme dhe objektivave për fushën e konsultimeve publike.

Progresi në drejtim të zbatimit të kriterëve, standardeve dhe procedurave të financimit publik të OSHC-ve është evident, dhe mund të thuhet se ekziston përmirësim sa i përket transparencës dhe llogaridhënies në financimin publik të OSHC-ve. Megjithatë, për të mbajtur këtë sistem funksional, është e nevojshme një rritje e vazhdueshme e kapaciteteve institucionale. Ka munguar progresi në objektivat e veçanta që kanë të bëjnë me krijimin e bazës ligjore që ndërlidhen me filantropinë individuale dhe të korporatave, dhe rrjedhimisht nuk janë avancuar kapacitetet institucionale në këtë fushë. Mungesa e rezultateve të prekshme edhe në fushën e rregullimit të bazës ligjore dhe zbatimit të saj sa i përket bashkëfinancimit të projekteve të OSHC-ve, ndikon negativisht në krijimin e një ambienti të qëndrueshëm për zhvillimin e projekteve të OSHC-ve. Rekomandohet që edhe në ciklin e ardhshëm të planifikimit strategjik të përfshihet kjo objektivë, dhe objektivat specifike. Një adresim më i mirë i treguesve, duke u siguruar që të jenë të matshëm, dhe që objektivat e synuara të kenë mbulueshmëri buxhetore.

Zhvillimi i Praktikave dhe Procedurave Transparente për Kontraktimin e Shërbimeve me OSHC-të, edhe pse shumë relevant dhe i rëndësishëm si për shoqërinë civile ashtu edhe për institucionet publike, nuk ka shënuar progres gjatë zbatimit të Strategjisë. Prandaj, gjithë përmbajtja e objektivës

83 DG NEAR Guidelines for EU Support to Civil Society in the Enlargement Region 2021-2027, i qasshëm në: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/EU-Guidelines-for-Support-to-Civil-Society-in-the-Enlargement-region-2021-2027.pdf>

84 OECD/SIGMA Principles of Public Administration. <https://www.sigmaweb.org/publications/principles-public-administration.htm>

strategjike mbetet relevante edhe për procesin e ardhshëm strategjik. Në radhë të parë, duhet fokusuar në krijimin e bazës ligjore që ka të bëjë me kontraktimin e shërbimeve, e cila është e mundshme të bëhet përmes akteve nënligjore që burojnë nga ligji i Prokurimit Publik. Më pastaj, duhet të punohet që kapacitetet institucionale të rriten. Meqë Ligji për Prokurim Publik është në proces ndryshimi, Qeveria, duhet të sigurohet që edhe më tej të ekzistojë dhe të avancohet baza ligjore për rregullim të kontraktimit të shërbimeve për OSHC-të.

Progresi në fushën e vullnetarizmit, gjatë ciklit të Strategjisë ka qenë minimal. Nga vlerësimi i Strategjisë është vlerësuar se kjo objektivë ka qenë dhe vazhdon të mbetet relevante. Rrjedhimisht, planifikimi i saj edhe në ciklin e ardhshëm strategjik është i domosdoshëm. Koncept Dokumenti për Vullnetarizmin të finalizohet dhe të përmirësohet platforma elektronike për vullnetarët. Është e rëndësishme të hartohet një bazë ligjore për kontraktim të vullnetarëve dhe të përmirësohen kapacitetet institucionale në këtë fushë. Për të përmirësuar pjesëmarrjen dhe rritjen e ndikimit të vullnetarizmit, duhet të zhvillohet një rregullativë dhe politikat për përkrahjen dhe promovimin e vullnetarizmit, duke përfshirë përmirësimin e platformës elektronike dhe krijimin e një rregullative specifike për aktivitetet vullnetare.

Këshilli për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile është një strukturë themelore që synon koordinimin e bashkëpunimit midis Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Organizatave të Shoqërisë Civile. Megjithatë, vlerësimi ka treguar se Këshilli ka hasur në sfida të cilat kanë kufizuar efektshmërinë e tij në raport me zbatimin e Strategjisë. Ndër shkaqet kryesore të këtyre sfidave përfshihen fakti që Këshilli është shpesh herë i limituar në rolin e raportuesit për zbatimin e Strategjisë dhe se anëtarët e Qeverisë kanë ndërruar shpesh, çka ka sjellë mungesë kujtesës institucionale. Për të avancuar efektshmërinë e Këshillit për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile dhe për të thelluar bashkëpunimin e Qeveri – Shoqëri Civile, është e nevojshme të adresohen shqetësimet në lidhje me funksionimin e Këshillit, përfshirë ndërrimet e shpeshta të anëtarëve, zëvendësimet në mbledhjet e këshillit, dhe përzgjedhjen e përfaqësuesve nga shoqëria civile të përfaqësuesve që përfaqësojnë interesin e shoqërisë civile në mënyrën më të mirë. Gjithashtu, do të ishte e rëndësishme të bëhej rritja e kapaciteteve njerëzore të Zyres për Qeverisje të Mirë në ZKM për të siguruar mbulimin e efektshëm të të gjitha fushave të përgjegjësisë së saj, në veçanti ato që ndërlidhen me Strategjinë.

LISTA E REFERENCAVE

- DG NEAR Guidelines for EU Support to Civil Society in the Enlargement Region 2021-2027 shih: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/EU-Guidelines-for-Support-to-Civil-Society-in-the-Enlargement-region-2021-2027.pdf>
- European Commission, Kosovo 2022 Report, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>
- European Commission, Kosovo 2023 Report, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SĚD_2023_692%20Kosovo%202023%20report.pdf
- Forumi për Iniciative Qytetare, Analizë Legjisacionit të Kosovës Ligjir me Filantropinë dhe OJQ-të, 2019, I qasshëm në: https://fiq-fci.org/file/repository/fiq-fci.org/Analize_legjisacionit_te_Kosoves_per_filantropi_dhe_OJQ.pdf
- Halili, Ruzhdi and Qerkin Berisha. "Public Consultation in Kosovo: Legal Framework, Methods, Tools, and Their Application." *Hrvatska i komparativna javna uprava* 23, no. 1. (2023): 61-90. <https://doi.org/10.31297/hkju.23.1.4>,
- Koncept Dokument për Dhënien Nën Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, i qasshëm në: <https://konsultimet.rks-gov.net/vieëConsult.php?ConsultationID=41689> dhe <https://mapl.rks-gov.net/news/mbahet-takimi-publik-per-koncept-dokumentin-per-dhenien-shfrytezim-dhe-kembimin-e-prones-komunale/?cptadid=143>
- Ligji Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=30537>
- Marrëveshje Financiare për IPA 2016 Pjesa e Dytë Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian shih <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15707>
- OECD/SIGMA Monitoring report on Kosovo 2021, i qasshëm në: <https://sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Kosovo.pdf>
- OECD/SIGMA Principles of Public Administration. <https://www.sigmaweb.org/publications/principles-public-administration.htm>
- Platforma CIVIKOS, Dokument i politikave lidhur me kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të, 2022. I qasshëm në: <https://civikos.net/wp-content/uploads/2023/12/DOKUMENT-I-POLITIKAVE-LIDHUR-ME-KONTRAKTIMIN-E-SHERBIMEVE-NGA-OSHC-te.pdf>
- Platforma e Financimit Publik të OjQ-ve, e qasshme në: <http://ojqfinancime.rks-gov.net/>.
- Raport i Monitorimit Zbatimi i Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 Këndvështrim i Sekretariatit të Platforma Civikos Prishtinë, tetor 2023, I qasshëm në: https://civikos.net/wp-content/uploads/2023/10/Raporti-3_compressed.pdf
- RAPORT VJETOR PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË QEVERTARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2019–2023 PËR VITIN 2019, Qershor 2020, i qasshëm në: <https://zgm.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/dokumentet/RAPORTI%20VJETOR%20P%C3%8BR%20STRATEGJIN%C3%8B%202019-TD.pdf>
- RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2020, https://www.zka-rks.org/ep-content/uploads/2021/07/RaportiAuditimit_K_PZ_2020_Shqip.pdf
- RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2021, https://zka-rks.org/ep-content/uploads/2022/06/RaportiAuditimit_K_PZ_2021

[Shqip-1.pdf](#)

- Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2021, I qashëm në: https://www.prishtinaonline.com/uploads/raportiauditimit_k_pr_2021_shqip.pdf
- Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Gjilanit për vitin 2021, i qashëm në: https://www.zka-rks.org/ëp-content/uploads/2022/05/RaportiAuditimit_K_GL_2021_Shqip.pdf
- Raporti për zbatim të Planit të Veprimit për Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, periudha e raportimit 2022;
- Raporti për zbatim të Planit të VEPRIMIT për Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, periudha e Raportimit, 2021;
- Raporti Vjetor për konsultimet publike në Reverinë e Republikës së Kosovës 2022, i qashëm në: <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-645b4128e5f52.pdf>
- Rregullat e Punës së Këshillit për Bashkëpunim të Qeverise me Shoqërinë Civile, shih: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/11/Rregullat-e-Punes-se-Keshillit-per-Bashkepunim-te-Qeverise-me-Shoqerine-Civile.pdf>
- RREGULLORE MF - NR - 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE, e qashme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14831>
- Rregullorja (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, e qashme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=30537>
- Rregullorja (QRK) Nr.05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15036>
- Statistikat sa i përket Konsultimeve publike: Shih: <https://konsultimet.rks-gov.net/statistics.php>
- Vendimi Nr.05/96 i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Themelimin e Këshillit për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile, datë 02.04.2019. Shih: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/11/Vendimi-per-themelimin-e-Keshillit.pdf>
- Weber 2.0, NATIONAL PAR MONITOR KOSOVO 2021/2022 Shih <https://www.par-monitor.org/national-par-monitor-2021-2022-kosovo/>
- Zyra Kombëtare e Auditimit, RAPORTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS: Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave jo-qeveritare, 2021, https://www.zka-rks.org/ëp-content/uploads/2021/07/RAP_FinancimiiOJQ_Shqip.pdf?fbclid=IëAR2gëgOGënRxeSov8UOJ_0g2g7G64KfiPjCcm5rJojE0eb5rKxzZ38A-cë
- Raport vjetor për konsultimet me publikun në Qeverinë e Republikës Së Kosovës për vitin 2019, I qashëm në: <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-5ea0545755580.pdf>
- Raport vjetor për konsultimet me publikun në Qeverinë e Republikës Së Kosovës për vitin 2020, I qashëm në: <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-606c64325720c.pdf>
- Raport vjetor për konsultimet me publikun në Qeverinë e Republikës Së Kosovës për vitin 2021, I qashëm në: <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-62bab5fb93501.pdf>
- Raport vjetor për konsultimet me publikun në Qeverinë e Republikës Së Kosovës për vitin 2022, I qashëm në: <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-645b4128e5f52.pdf>
- Metodologjia për Monitorimin dhe Raportimin e Konsultimeve Publike, <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-591ed23978b96.pdf>

SHTOJCAT

SHTOJCA I. ZBATIMI I AKTIVITETEVE SIPAS OBJEKTIVAVE TË STRATEGJIS¹

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: RITJIA E PJESËMARRJES SË SHOQËRISË CIVILE NË POLITIKËBËRJE

Objektivi specifik 1.1 Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve për zbatimin e standardeve minimale për konsultimet me publikun		
Aktivitetet	Produkti (Outputi)	Zbatimi
1.1.1 Ofrimi i njohurive mbi Rregulloren për standardet minimale për konsultime me publikun	Tri sesione informuese për ministrinë dhe komunat e përzgjedhura të realizuara Raporti për trajnimet i publikuar	
1.1.2 Vendosja e rregullave dhe standardeve për konsultimet me publikun në nivel lokal	Standardet dhe rregullat për konsultime me publikun të miratuara dhe në funksion	
1.1.3 Ofrimi i një Programi trajnues për institucionet qeveritare qendrore dhe lokale për metodat e përfshirjes së OShC-ve në hartimin e politikave	Programi trajnues për institucionet qeveritare për metodat e përfshirjes së OShC-ve në hartimin e politikave i finalizuar dhe i shpërndarë Realizimi i 9 sesioneve trajnuese për ministri dhe komuna të përzgjedhura.	
1.1.4 Avancimi dhe rritja e përdorimit të Platformës Online për konsultime me publikun	Platforma online e përmirësuar. Udhëzuesi i uebit i zhvilluar dhe përdorur nga institucionet shtetërore	
1.1.5 Ofrimi i trajnimeve në vendin e punës për ministrinë e përzgjedhura në përgatitjen e raporteve mbi rezultatet e konsultimeve publike	Trajnimet në vendin e punës për 7 ministri e përzgjedhura në përgatitjen e raporteve mbi rezultatet e konsultimeve publike të realizuara	
1.1.6 Organizimi i sesioneve trajnuese praktike për shfrytëzimin efektiv të Platformës Online	5 Sesione trajnuese me Ministrinë dhe komunat	
1.1.7 Organizimi i takimeve koordinuese për ministrinë dhe zyrat e kryeministrit	6 takime të realizuara	
1.1.8 Publikimi i raporteve vjetore të monitorimit mbi zbatimin e standardeve minimale për konsultime me publikun në nivel qendror dhe lokal	Raportet vjetore të monitorimit të publikuara në kohë dhe në përputhje me kërkesat e Rregullores	

¹ Me ngjyrë të gjelbër janë hijezuar aktivitetet plotësisht të zbatuara, me ngjyrë të kaltër aktivitetet pjesërisht të zbatuara, me ngjyrë të verdhë aktivitetet në proces të zbatimit ndërsa me ngjyrë të kuqe aktivitetet e pazbatuara.

1.1.9 Publikimi i praktikave më të mira të konsultimit me institucionet shtetërore dhe komunat	Praktikat më të mira të mbledhura, publikuara dhe të promovuara nëpër institucionet qendrore dhe lokale.	Yellow
1.1.10 Rekrutimi i një zyrtari për koordinimin e procesit të konsultimeve me publikun	Zyrtari i ri është rekrutuar dhe në punë	Red
Objektivi specifik 1.2 Ngritja e njohurive të qytetarëve dhe shoqërisë civile për konsultimet publike		
1.2.1 Zhvillimi dhe zbatimi i një strategjie të komunikimit me publikun për Platformën Online dhe standardet për konsultimet me publikun	Strategjia e komunikimit me publikun e zhvilluar, publikuar dhe plotësisht në funksion	Yellow
1.2.2 Zhvillimi i një fushate për ngritjen e vetëdijes për standardet e konsultimit me publikun	Udhëzuesi për shfrytëzimin e platformës online për konsultime me publikun nga OSHC-të dhe qytetarët i zhvilluar dhe i shfrytëzueshëm	Green
	3 Video spote në platformën online të zhvilluara dhe të transmetuara në TV dhe radio stacionet më të mëdha, si dhe përmes rrjeteve sociale	
	Dizajnimi, shtypja dhe shpërndarja e fletushkave për platformën online	
Objektivi specifik 1.3 Përmirësimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuar në procesin e konsultimeve publike		
1.3.1 Mbajtja e sesioneve informuese për rritjen e kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuar në procesin e konsultimeve publik	Sesionet informuese të mbajtura për 5 qendra rajonale (Pejë, Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Prizren)	Red

Burimi: Platforma CIVIKOS & Zyra për Qeverisje të Mirë në ZKM

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: PËRMIRËSIMI I KORNIZËS INSTITUCIONALE DHE LIGJORE PËR FINANCIM NË ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË PROGRAMEVE DHE PROJEKTEVE TË OSHC-ve ME INTERES PUBLIK²

Objektivi specifik 2.1 Fuqizimi i kapaciteteve të Ministrive dhe Komunave për zbatimin e standardeve për financimin publik të OShC-ve		
Aktivitetet	Produkti (Outputi)	Zbatimi
2.1.1 Zhvillimi i programit trajnues për ministritë dhe komunat për zbatimin e Rregullores dhe për vlerësimin e propozimeve të projekteve dhe programeve të OSHC-ve për ministritë dhe komunat	Programi i trajnimit i zhvilluar dhe realizimi i sesioneve trajnuese dhe punëtorive për vlerësimin e projekteve/programeve të organizatave të shoqërisë civile në nivel qendror dhe lokal	
2.1.2 Ofrimi i trajnimeve në vend të punës dhe mentorimi (duke përfshirë edhe rolin mbikëqyrës) për ministritë dhe komunat në përgatitjen dhe zbatimin e thirrjeve për financim publik të projekteve dhe programeve të OSHC-ve	Realizimi i trajnimeve në vendin e punës dhe mentorimi i dhënë për së paku 9 ministri dhe 15 komuna	
2.1.3 Organizimi i takimeve bashkërenduese për ZKM, ministritë dhe komunat për planifikimin e përbashkët dhe raportimin për financimin publik të OSHC-ve	Takime koordinuese të mbajtura, se paku 5 sosh.	
2.1.4 Publikimi i raporteve vjetore për financimin publik të OSHC-ve në Kosovë	Raportet vjetore të publikuara në kohë dhe në përputhje me kërkesat e Rregullores	
2.1.5 Përmirësimi i bazës qendrore të të dhënave për financimin publik të OSHC-ve në Kosovë. ojqfinancime.rks-gov.net	Platforma qendrore online e të dhënave për financimin publik të OSHC-ve e zhvilluar dhe tërësisht funksionale	
2.1.6 Rishikimi i Manualit për zbatimin e Rregullores për Financimin Publik të OSHC-ve	Manuali i rishikuar dhe përditësuar në bazë të komenteve dhe te gjetjeve nga Ministritë, Komunat dhe OSHC-të	
2.1.7 Rritja e rolit mbikëqyrës të MF-së në zbatimin e Rregullores	Letra qarkore e dërguar nga MF (Dep. e Buxhetit) për zbatimin e Rregullores për ministritë	
2.1.8 Krijimi i bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet OB dhe OSHC-ve lidhur me ciklin e financimit të OSHC-ve për financat publike (planifikimi, ekzekutimi dhe auditimi)	Konsultimet publike mbi planin vjetor të thirrjeve publike nga niveli qendror dhe lokal për financimin e OSHC-ve të realizuara duke përfshirë planifikimin, ekzekutimin dhe monitorimin	

² Me ngjyrë të gjelbër janë hijezuar aktivitetet plotësisht të zbatuara, me ngjyrë të kaltër aktivitetet pjesërisht të zbatuara, me ngjyrë të verdhë aktivitetet në proces të zbatimit ndërsa me ngjyrë të kuqe aktivitetet e pazbatuara.

Objektivi specifik 2.2: Përmirësimi i kornizës ligjore dhe institucionale për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave		
2.2.1 Të rishikohet korniza ligjore e përkufizimit dhe rregullimit të filantropisë (duke përfshirë dhurimet, harmonizimin e fushave të OBP-së)	Koncept dokumentet për krijimin e një kornize ligjore gjithëpërfshirëse për filantropinë të përgatitura	
2.2.2 Dizajnimi dhe zhvillimi i programit/sistemit trajnues për zyrtarët e tatimit për praktikën vendore dhe ndërkombëtare të administrimit të përfitimeve tatimore për filantropinë individuale dhe të korporatave	Programi trajnues i dizajnuar dhe zhvilluar dhe mbajtja e sesione trajnuese.	
2.2.3 Krijimi dhe fuqizimi i mekanizmave institucional për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave	Përgjegjësitë institucionale për monitorimin dhe përmirësimin e kornizës ligjore dhe të politikave për filantropinë të përkufizuara Personeli përkatës i trajnuar nga institucionet përgjegjëse për politikën e filantropisë	
2.2.4 Fushatat informuese për biznese dhe qytetarë për mundësinë që individët ose korporatat ofrojnë për filantropinë	Fletëpalosjet e dizajnuara dhe të shtypura (1000 kopje) Fletëpalosjet e shpërndara te qytetarët dhe bizneset	
Objektivi specifik 2.3. Rregullimi i ndarjes së pronës publike për shfrytëzim nga OSHC-të		
2.3.1 Krijimi i standardeve, procedurave, kritereve dhe mekanizmave institucional transparent për rregullimin e dhënies së pronave shtetëror në shërbim të OSHC-ve	Standardet dhe Procedurat janë hartuar dhe miratuar	
2.3.2 Dizajnimi dhe zhvillimi i një programi/ sistemi trajnues për shërbyesit civil mbi përdorimin e standardeve dhe procedurave për rregullimin e dhënies së pronës publike në shfrytëzim të OSHC-ve	Trajnimi i dizajnuar dhe i zhvilluar për zbatimin e standardeve dhe procedurave	
2.3.3 Zhvillimi i Regjistrit Elektronik të pronave shtetërore të dhëna në shfrytëzim të OSHC-ve	Regjistri Elektronik i përgatitur dhe funksional	
Objektivi specifik 2.4. Krijimi i një sistemi të bashkëfinancimit për projektet e OSHC-ve të financuara nga BE-ja		
2.4.1 Krijimi i mekanizmit financiar në Ministrinë e Integritetit për Bashkëfinancimin e projekteve të financuara nga BE për OSHC-të	Mekanizmi i financimit është krijuar dhe është funksional	
2.4.2 Vendosja e standardeve, procedurave dhe mekanizmave institucional për bashkëfinancimin e projekteve të OSHC-ve të mbështetura nga BE-ja	Analiza e praktikave të mira në bashkëfinancimin e projekteve të OSHC-ve të mbështetura nga BE-ja i përgatitur Standardet dhe procedurat e miratuara dhe institucioni përgjegjës me buxhetin përkatës është vendosur.	

2.4.3 Dizajnimi dhe zhvillimi i një programi/ sistemi trajnues për shërbyesit civil dhe OSHC-të për përdorimin e standardeve dhe procedurave për bashkëfinancimin e projekteve të OSHC-ve të mbështetura nga BE-ja	Programi i trajnimit i dizajnuar dhe zhvilluar për personelin përkatës të institucioneve përgjegjëse.	Red
2.4.4 Mbajtja e sesione informuese për OSHC-të për mundësitë e bashkëfinancimit të projekteve të mbështetura nga BE-ja	5 sesione informuese të mbajtura në rajonet kryesore.	
2.4.5 Rekrutimi i zyrtarit të ri për koordinimin e procesit të financimit publik të OSHCve	Zyrtar i ri i rekrutuar dhe në punë.	Green

Burimi: Platforma CIVIKOS & Zyra për Qeverisje të Mirë në ZKM

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: ZHVILLIMI I PRAKTIKAVE DHE PROCEDURAVE PËR KONTRAKTIMIN E OSHC-VE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE³

Objektivi specifik 3.1. Përmirësimi i kornizës së përgjithshme ligjore dhe institucionale për rregullimin e aktiviteteve ekonomike të OJQ-ve		
Aktivitetet	Produkti (Outputi)	Zbatimi
3.1.1 Konsolidimi i kornizës së përgjithshme ligjore, duke përfshirë legjislacionin tatimor, në lidhje me aktivitetet ekonomike të OSHC-ve	Hartimi i një analize të politikave për dispozitat që duhet të adresohen Përgatiten Korniza ligjore është konsoliduar (posaçërisht Ligji për Tatimin në të Ardhura të Korporatave) Korniza ligjore është në zbatim	
3.1.2 Përgatitja e Udhëzimeve për zbatimin e kornizës së konsoliduar ligjore me raste studimore	Udhëzimet janë përgatitur	
3.1.3 Organizimi i sesioneve informuese për shërbyesit civil, duke përfshirë zyrtarët tatimor, për t'i informuar ata për ndryshimet në kornizën ligjore	Tri sesione informuese të mbajtura	
Objektivi specifik 3.2. Përmirësimi i njohurive të institucioneve rreth mundësive (modeleve) ekzistuese për kontraktimin e OSHC-ve		
3.2.1 Finalizimi i vlerësimit të nevojave për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të në fusha të ndryshme të punës	Vlerësimi i nevojave i formuluar për të vendosur standardet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të	
3.2.2 Dizajnimi dhe zhvillimi i një programi trajnues për shërbyesit civil për të mësuar rreth kornizës ligjore dhe modelet ekzistuese për kontraktimin e OSHC-ve në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike	Trajnimi është dizajnuar dhe zhvilluar për kornizën ligjore dhe modelet ekzistuese për kontraktimin e OSHC-ve Mbajtja e 6 sesioneve të trajnimeve për kontraktim të OSHC-ve	
3.2.3 Lansimi fushatës për informim publik për OSHC-të rreth mundësive për të ndihmuar qeverinë të ofrojë shërbime publike	Fushata e informimit publik e përgatitur 8 sesioneve të informimit publik të mbajtura	
Objektivi specifik 3.3. Mbledhje dhe publikim sistematik i informatave mbi potencialin e OShC-ve për te ofruar shërbime publike për institucionet publike		
3.3.1 Krijimi i një baze të të dhënave me të gjithë informacionin e nevojshëm për OSHC-të të cilat ofrojnë shërbime publike dhe OSHC-të e mundshme të cilat mund të bëhen ofrues të shërbimeve	Dizajni i databazës i kompletuar Databaza është lansuar Të gjitha OSHC-të janë regjistruar si ofrues të mundshëm të shërbimeve publike	

³ Me ngjyrë të gjelbër janë hijezuar aktivitetet plotësisht të zbatuara, me ngjyrë të verdhë aktivitetet në proces të zbatimit ndërsa me ngjyrë të kuqe aktivitetet e pazbatuara.

Objektivi specifik 3.4. Përmirësimi i legjislacionit që rregullon standardet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të	
3.4.1 Krijimi i standardeve, procedurave dhe kriterëve për rregullimin e ofrimit të shërbimeve publike nga OSHC-të	Standardet dhe Procedurat janë hartuar dhe miratuar
3.4.2 Përgatitja e Manuali Online me udhëzime për kontraktimin e OSHCve për ofrimin e shërbimeve publike, në bazë të kornizës ligjore të ndryshuar	Doracaku me udhëzime për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike është përgatitur dhe shpërndarë, në bazë të kornizës ligjore të ndryshuar Manuali i publikuar në ueb faqe

Burimi: Platforma CIVIKOS & Zyra për Qeverisje të Mirë në ZKM

OBJEKTIVIT STRATEGJIK 4: RITJA E VULLNETARIZMIT PËR PROGRAMET ME INTERES PUBLIK⁴

Objektivi specifik 4.1. Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programet me interes publik		
Aktivitetet	Produkti (Outputi)	Zbatimi
4.1.1 Të hartohet dhe miratohet Koncept Dokumenti mbi Vullnetarizmin	Koncept dokumenti për rregullimin dhe promovimin e vullnetarizmit i përgatitur Rekomandimet e koncept dokumentit mbi vullnetarizmin dhe masat të tjera të nevojshme të miratuara; Rekomandimet e koncept dokumentit janë miratuar duke siguruar zbatimin e qëndrueshëm	
4.1.2 Implementimi i rekomandimeve nga Koncept dokumenti	Koncept dokumenti për rregullimin dhe promovimin e vullnetarizmit i përgatitur Rekomandimet e koncept dokumentit mbi vullnetarizmin dhe masat të tjera të nevojshme të miratuara; Rekomandimet e koncept dokumentit janë miratuar duke siguruar zbatimin e qëndrueshëm	
Objektivi specifik 4.2. Zhvillimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të rekrutuar, angazhuar dhe menaxhuar vullnetarët		
4.2.1 Lansimi i një skeme të granteve për financimin e aktiviteteve për zhvillimin e kapaciteteve për OSHC-të për menaxhimin efektiv të vullnetarëve	Skema e granteve e publikuar dhe 4-5 OSHC të kontraktuara për të ofruar programe trajnimi për menaxhimin efektiv të vullnetarëve në komunitetet e tyre lokale Ligjet e nevojshme të ndryshuara; Gazeta zyrtare; faqet e internetit të ZQM/ZKM; Raportet mbi zbatimin e Strategjisë	
4.2.2 Përgatitja e një Manuali me udhëzime për rekrutimin dhe menaxhimin e vullnetarëve	Manuali me udhëzimet për angazhimin e vullnetarëve i përgatitur dhe shpërndarë, në bazë të ndryshimeve të kornizës ligjore Manuali i publikuar në ueb faqen e ZQM/ZKM-së.	
Objektivi specifik 4.3. Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për mundësitë dhe vlerat e vullnetarizmit		
4.3.1 Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për mundësitë dhe vlerat e vullnetarizmit	Video spoti për rëndësinë e vullnetarizmit i përgatitur dhe i transmetuar në media Fletushkat rreth asaj se si mund të organizohet vullnetarizmi i përgatitur dhe shpërndarë	
4.3.1 Përmirësimi i regjistrit Online për vullnetarët e rinj të regjistruar	Regjistri Online i përmirësuar Regjistri Online i përmirësuar dhe tërësisht në përdorim	

Burimi: Platforma CIVIKOS & Zyra për Qeverisje të Mirë në ZKM

⁴ Me ngjyrë të verdhë janë hijezuar aktivitetet në proces të zbatimit ndërsa me ngjyrë të kuqe aktivitetet e pazbatuara.

SHTOJCA 2: Lista e pjesëmarrësve në Punëtori/fokus groupin e Organizuar më 24.10.2023 për Vlerësimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile

Nr.	Emri	Mbiemri	Organizata/Institucioni
1	Ajete	Kërqeli	Fondacioni "Shtatëmbëdhjetë"
2	Albanë	Hoti	Organizata për fëmijët pa kujdes prindëror - OFAP
3	Albesa	Humolli	Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)
4	Artë	Kastrati	Platforma CIVIKOS
5	Avdyl	Gashi	Qendra e Rinisë, Drenas
6	Dardan	Kryeziu	Platoforma CIVIKOS
7	Detjan	Hulaj	Organizata Adresa
8	Djellza	Zejnullahu	Edutask
9	Dren	Puka	Kosovo Civil Society Foundation (KCSF)
10	Eranda	Zekaj	Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)
11	Etleva	Malushaj	Rrjeti i Grave të Kosovës
12	Fjolla	Muçaj	Qendra për Informim dhe Përmirësim Social - QIPS
13	Habit	Hajredini	Zyra për Qeverisje të Mirë
14	Imran	Rasimi	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
15	Kadrije	Krasniqi	Balkan Sunfloëers Kosova
16	Mjellmë	Doli	Kosovo Civil Society Foundation (KCSF)
17	Nermin	Mahmuti	Fondi për Zhvillim Komunitar (CDF)
18	Qëndrim	Hoxha	Leadership Development Association (LDA) Europe
19	Qerkin	Berisha	Ekspert i angazhuar për Vlerësimin e Strategjisë
20	Remzije	Krasniqi	SOS FSHATRAT E FËMIJËVE
21	Ruzhdi	Osmani	Ministria e Drejtësisë
22	Ruzhdi	Halili	Ekspert i angazhuar për Vlerësimin e Strategjisë
23	Trëndelinë	Dreshaj	Zyra për Qeverisje të Mirë
24	Vlora	Shabiu	IPKO Foundation

SHTOJCA 3: Lista e personave të intervistuar gjatë procesit të Vlerësimit të Zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile

Nr.	Emri	Miemri	Organizata/Institucioni	Data e intervistës/ takimit
1	Afërdita	Pustina	Country Coordinator for Kosovo, Technical Assistance to Civil Society Organisations (EU TACSO 3) in the Eastern Balkans and Turkey	06.11.2023
2	Agmie	Osmani	OJQ Folloë UP	30.10.2023
3	Artë	Kastrati	Platforma CIVIKOS	21.09.2023
4	Avdyl	Gashi	Qendra e Rinisë, Drenas	29.09.2023
5	Dardan	Kryeziu	Platforma CIVIKOS	01.09.2023; 21.09.2023
6	Donika	Emini	Platforma CIVIKOS	01.09.2023
7	Dorina	Lluka	Young Men's Christian Association (YMCA)	10.10.2023
8	Dren	Puka	Kosovo Civil Society Foundation (KCSF)	11.10.2023
9	Habit	Hajredini	Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit	20.09.2023; 17.10.2023
10	Richard	Allen	Team Leader, Technical Assistance to Civil Society Organisations (EU TACSO 3) in the Eastern Balkans and Turkey	06.11.2023
11	Trëndelinë	Dreshaj	Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit	20.09.2023; 17.10.2023
12	Vlorian	Molliqaj	Action for Mothers and Children, koordinator i Ekipit 3 të Këshillit për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile, për Objektiven për kontraktimin e shërbimeve	04.10.2023
13	Jehona	Gjurgjeala	OJQ Toka	09.10.2023

